



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28 regjistër (JR)
Datë 10.07.2020

Nr. 13 i vendimit
Datë 10.06.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 10.06.2021, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 28/2020 (JR), datë 10.07.2020, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Martini.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 e F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Anton Martini, dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij Julian Mërtiri, të cilët përfundimisht, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Anton Martini (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas të cilave ka rezultuar:
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka referuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës* për subjektin e rivlerësimit.
4. Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim “GPPP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga vetë subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse siç janë pasqyruar më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale – duke marrë vendimin nr. 231, datë 29.01.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Anton Martini, me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.
7. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

7.1 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balancat negative të fondeve në disa vite, për një total të akumuluar në shumën prej 257.000 lekësh, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara apo balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe duke konsideruar faktin se mangësitë financiare janë në vlera relativisht të vogla e të shpërndara në vite, mund të gjejnë mbulim në shpjegimet e dhëna nga subjekti me prapësimet e dërguara, për të cilat Komisioni me të drejtë vlerësoi se janë të karakterit deklarativ dhe, si të tilla, nuk janë reflektuar në analizën financiare.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

Gjithashtu, në lidhje me kredinë e përfitur në vitin 2007, Komisioni vlerëson se përdorimi i mjeteve monetare të përfituara me anë të kredisë, me kritere lehtësuese nga subjekti dhe të përdorura për blerjen e bonove të thesarit, duke siguruar të ardhura për përbalimin e qirasë së shtëpisë dhe të kësteve të kredisë, nuk përputhen me etikën e prokurorit dhe duket sikur e cenon atë. Nga ana tjetër, pasi analizoi qëllimin e përdorimit të kësaj kredie, masën e të ardhurave të siguruara, mënyrën e përdorimit të tyre, Komisioni arrin në konkluzionin se kjo shkelje nuk mund të jetë shkak i mjaftueshëm për shkarkimin e subjektit. Një rast i shkëputur nuk mund të jetë cenim i etikës së prokurorit, sidomos duke vënë në balancë rezultatet profesionale të punës së tij si prokuror i krimeve të rënda.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7.2 Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7.3 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit. Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

8. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 231, datë 29.01.2020, për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar se ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve e provave dhe ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.
9. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e ankimit të tij t’i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:
 - o Ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
10. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Referuar deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë, deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, rezultateve të hetimit administrativ, akteve të administruara dhe konkluzioneve të arritura nga Komisioni, Komisioneri

Publik ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Për këtë arsye, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë, për këto shkaqe:

11.1 Komisioneri Publik, për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe banimi 97,16 m², sipërfaqe të përbashkët 10,74 m², sipërfaqe tarrace 25,95 m² dhe një post garazhi”, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së këstit të parë, pasi:

a) vlera e blerjes së kësaj pasurie është përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 85.000 euro, në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit administrativ;

b) për tërheqjet nga llogaritë bankare, të cilat janë kryer në vitet 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore të interesave në vitet 2007-2010, posedimin e tyre *cash* në banesë. Për këtë arsye, shuma prej 37.400 eurosh që rrjedh nga depozitimet në Raiffeisen Invest në vitet 2010-2011, e deklaruar nga subjekti si e ardhur me burim fillestar kredinë e marrë në Bankën Raiffeisen në vitin 2007, nuk justifikohet me burime të ligjshme;

c) lidhur me plotësimin e shumës 50.000 euro në datën e pagesës 07.04.2015, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e deklaruar të kësaj pagese me të ardhura nga kredia e marrë me kushte lehtësuese në vitin 2007 dhe nuk justifikon me burime të ligjshme kryerjen e kësaj pagese.

11.2 Lidhur me kursimet *cash* të krijuara gjatë periudhës 2003-2016, të deklaruara në deklaramet periodike vjetore të interesave dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, pasi:

a) treguesit e analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me gjendjen e parave *cash*/kursimet ndër vite, duhet të bazoheshin vetëm mbi sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaramet periodike, si për shumat e deklaruara të kursyera, edhe për burimin e deklaruar të tyre, dhe jo mbi sa ai ka shpjeguar gjatë shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ;

b) Komisioni nuk duhet të kishte përfshirë në analizën financiare të ardhurat e deklaruara të dhuruara nga vëllai i subjektit, z. D.M., në periudhën 2011-2014, përse kohë që rezulton se të ardhurat e dokumentuara nga personi tjetër i lidhur nuk janë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës në Mbretërinë e Bashkuar dhe dhurimet e bëra;

c) subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 2003-2016, në një diferencë negative më të thelluar se sa ajo e përlllogaritur nga Komisioni.

Shkaqe që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

12. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim se vlerësimi i Komisionit për këtë kriter është i cenueshëm, pasi bazohet në një vlerësim jo të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm. Komisioni nuk ka vlerësuar drejt të dhënat e raportit të GPPP-së, si dhe të dhënat e rezultuara nga hetimi i kryer mbi denoncimet e publikut. Për këto arsye, Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e

aplikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Konkretisht:

12.1 Në lidhje me ankesën e gazetarit A.Xh., drejtuar me *e-mail* Prokurorit të Përgjithshëm, protokolluar me nr. {***}, datë 06.01.2014 dhe nr. {***}, datë 06.01.2014, nga Zyra e Sektorit Publik pranë Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, nuk ka mbledhur provat e nevojshme të kërkuara me ligj, nuk ka treguar aftësinë për të marrë në pyetje, mosveprime të cilat kanë çuar në shmangien nga dënimi më i rëndë i autorëve të kryerjes së veprës penale në disa episode, si dhe kanë sjellë pasoja të rënda për shtetas të tjerë, të cilat eventualisht mund të ishin shmangur në rast të hetimit të plotë të kallëzimit të depozituar nga shtetasi A.Xh.

12.2 Në lidhje me ankimin me nr. {***}, datë 26.01.2015, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Inspektorit të Etikës pranë Prokurorit të Përgjithshëm, rasti në fjalë duhet trajtuar si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të profesionit, parashikuar nga neni 103 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit duke realizuar komunikime të papërshtatshme dhe në shkelje të etikës, duket se ka kërkuar të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, premtime, sjellje kjo dhe në kundërshtim me rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve.

12.3 Në lidhje me tri nga dosjet e përzgjedhura me short, pjesë e raportit të vlerësimit të hartuar nga GPPP-ja, Komisioni nuk ka trajtuar në vendim mangësitë procedurale të konstatuara dhe detyrimet/përgjegjësitë e mundshme të subjektit në hetimin e rasteve. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për të tria rastet e sipërcituara nuk janë bindëse dhe të mbështetura ligjërisht. Mosrespektimi i afateve kohore për pushimin e procedimeve penale dhe mosnjoftimi i palëve të përfshira në një kallëzim/procedim penal për mosfillimin ose pushimin e procedimit, është në shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, që kanë qenë në fuqi në periudhat përkatëse.

12.4 Në lidhje me denoncimin nr. {***} prot., datë 11.12.2019, të depozituar në Komision pas zhvillimit të seancës dëgjimore datë 10.12.2019, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve shtesë të hetimit. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, nuk dokumentoi procedurat e hedhjes së shortit dhe mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të strukturës përkatëse, e cila sipas nenit 55, pika 2, shkronja “c” e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, jep mendim për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre.

12.5 Komisioneri Publik, në pamundësi për të mbledhur vetë prova, sjell në vëmendje të Kolegjit nevojën për hetimin dhe vlerësimin e denoncimit të publikut, protokolluar më datë 03.06.2020 pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, ku ndër të tjera pretendohet për komunikime telefonike të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në procedime penale, si dhe referon ankesa të prokurorëve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, lidhur me rastet kur janë zëvendësuar nga subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës së drejtuesit të kësaj prokurorie.

Shkaqe që lidhen me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

- 13.** Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të konkluduara nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, çmon se në zbatim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Konkretisht:

13.1 Subjekti i rivlerësimit ka përdorur për vite me radhë si investim financiar, vlerën e një kredie me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë e mbështetje financiare që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare, për të përfituar interesa nga “Bono thesari” për periudhën 2007 - 2008 dhe interesa nga depozitat bankare për periudhën 2011- 2015. Këto veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit për qëllim përfitimi financiar, janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një prokuror dhe cenonjë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

13.2 Mosveprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me ankesën e gazetarit A.Xh., të cilat kanë çuar në shmangien nga dënimi më i rëndë i autorëve të kryerjes së veprës penale në disa episode, kanë sjellë pasoja të rënda për shtetas të tjerë, të cilat eventualisht mund të ishin shmangur, në rast të hetimit të plotë të kallëzimit të depozituar nga z. Xh., duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut në rolin e organit të Prokurorisë, duke gjetur zbatim neni 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

13.3 Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të konkluduara edhe nga raporti i GPPP-së mbi tri nga dosjet e përzgjedhurame short, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni duhet të kishte arsyetuar mbi gjetjet e përsëritura të këtyre rasteve, duke konstatuar se për to gjen zbatim neni 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

- 14.** Në përfundim, Komisioneri Publik ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

- 15.** Kundër ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit, në datën 22.06.2020¹, ka paraqitur kundërankim, duke kërkuar që Kolegji:
- a) të prishë vendimin nr. 231/1, datë 16.06.2020, “Për pranimin e ankimit” të Komisionit;
 - b) të mos pranojë ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Martini;
- pasi ky ankim është paraqitur jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë, ka kërkuar nga Kolegji që të mos i shqyrtojë në themel shkaqet e paraqitura në ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit.

V. Vlerësimi i trupit gjyqësor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

a) Juridiksioni i Kolegjit

- 16.** Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të

¹ Protokolluar në Komision me nr. {***}prot., datë 22.06.2020.

Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

17. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

18. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 231, datë 29.01.2020, si dhe kundërankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ndaj ankimit të Komisionerit Publik, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
19. Në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor duke paraqitur prova të reja, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në seancën gjyqësore të datës 01.04.2021, vendosi:
- (i) riçeljen e hetimit gjyqësor;
 - (ii) të pranojë marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit².

²Në seancën gjyqësore të datës 30.03.2021, subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues marrjen dhe shqyrtimin në seancë gjyqësore të provave të renditura si më poshtë.

1. Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë nr. {***} prot., datë 29.03.2021, me lëndë: “Në lidhje me kërkesën për informacion”, bashkëlidhur së cilës gjendet kopje e njësuar me origjinalin me vulën e protokollit të Ministrisë së Drejtësisë, të shkresës nr. {***} prot., datë 25.03.2020, me lëndë: “Dërgohet projektakti normativ për shqyrtim dhe miratim, bashkëlidhur së cilës gjendet projektakti normativ “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19” dhe relacion për projektaktin normativ “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19”, si dhe shkresë e Ministrisë së Drejtësisë nr. {***} prot., datë 26.05.2020, drejtuar Komisionit të pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me lëndë: “Mbi fushëveprimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19”.

2. Shkresë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***} prot., datë 18.03.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje”.

3. Shkresë e Departamentit të Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. {***} prot., datë 06.12.2019, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje tuajës nr. {***} prot., datë 27.11.2019”.

4. Letër reference, datë 27.11.2020, e nënshkruar nga z. A. B. R., Shef i Zyrës Ndërlidhëse të vendeve Nordike për Bashkëpunimin Policor dhe Doganor Shqipëri dhe Kosovë, për z. Anton Martini, në gjuhën angleze dhe shqipe.

5. Certifikatë e Sigurimit të Personelit, lëshuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 19.03.2021, për z. Anton Martini, e vërtetuar njësisë me origjinalin me nr. {***} rep., datë 29.03.2021.

6. Shkresë e Drejtorisë kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë në Departamentin e Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nr. {***} prot., datë 29.03.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur së cilës gjendet kopje e njësuar me origjinalin e shkresës nr. {***} prot., datë 02.12.2019, e Departamentit të Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje tuajës nr. {***} prot., datë 21.11.2019”.

7. Shkresë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***} prot., datë 19.02.2020, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Dërgohet vendimi për dhënien e mbrojtjes së veçantë prokurorit Anton Martini”, bashkëlidhur së cilës gjendet vendimi i

20. Në seancën gjyqësore të datës 11.05.2021, subjekti i rivlerësimit, në funksion të prapësimeve të shkaqeve të ankimit, paraqiti në cilësinë e provës vendimin nr. {***}, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili u pranua të merret në cilësinë e provës nga trupi gjyqësor, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016.
21. Lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, të listuara si më sipër, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, trupi gjyqësor vendosi nënshkrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekti shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.
22. Pranë Kolegjit, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit janë depozituar denoncimet si më poshtë.
- Denoncimi i z. D.Z., datë 28.01.2020, i paraqitur nëpërmjet postës elektronike në rubrikën “Denonco”, në faqen zyrtare në internet të Kolegjit, i protokolluar në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 28.01.2020.
 - Denoncimi i z. B.B., i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.2021.
 - Denoncimi anonim, i protokolluar në Institucionin e Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 03.06.2020, i përcjellë në Kolegj nga Institucioni i Komisionerëve Publikë me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2021 dhe i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.2021.
 - Denoncimi i znj. A.I., i protokolluar në Kolegj me nr. 633 prot., datë 17.05.2021.
- Këto denoncime të publikut iu njoftuan subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar.
23. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre denoncimeve, trupi gjyqësor konstatoi se ato lidheshin me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjyqësor, bazuar në

*Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***}, datë 18.02.2020, “Për dhënien e mbrojtjes së veçantë të prokurorit Anton Martini”.*

8. *Shkresë e Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***} prot., datë 05.03.2021, drejtuar z. A. V., me lëndë: “Dërgohet vendimi për dhënien e mbrojtjes për prokurorin z. Anton Martini”, bashkëlidhur së cilës gjendet Vendimi i Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***}, datë 22.02.2021, “Për dhënien e mbrojtjes së veçantë fizike për z. Anton Martini, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për periudhën nga data 22.02.2021-21.06.2021”.*

9. *Shkresë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. {***} prot., datë 18.03.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje kërkesës tuaj të depozituar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.*

10. *Shkresë e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nr. {***} prot., datë 24.03.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje”.*

11. *Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nr. {***} prot., datë 29.01.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje”.*

12. *Printime të lajmeve të publikuara në median e shkruar dhe elektronike në lidhje me çështje penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit Anton Martini.*

13. *Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nr. {***} prot., datë 19.03.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje”.*

14. *Shkresë e Departamentit të Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. {***} prot., datë 15.02.2021, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Kthim përgjigje”.*

15. *Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. {***} prot., datë 10.12.2020, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Konfirmim nga TIMS për hyrje-daljet e shtetasit A. Xh.”.*

16. *Vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 29.03.2021, i deklaratës noteriale të shtetases E. M., datë 25.03.2021, në Mbretërinë e Bashkuar, me vulë apostille dhe dokumentacionit bashkëlidhur kësaj deklaratë: formularë të vetëvlerësimit tatimor për periudhat 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2016-2017, në gjuhën angleze dhe shqipe sipas vërtetimit të përkthimit nr. {***} rep., datë 30.03.2021.*

17. *Deklaratë zëvendësuese e aktit noterial e znj. V. Ll., në {***} Itali, datë 01.12.2020, me vulë apostille.*

parashikimet e neneve 45 dhe 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në seancën gjyqësore të datës 19.04.2021, me vendim të ndërmjetëm vendosi të çelë hetimin gjyqësor për denoncimin e z. D.Z., protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.01.2020 dhe denoncimin anonim, të përcjellë në Kolegj nga Institucioni i Komisionerëve Publikë dhe i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.201, i cili përbënte dhe njërin nga shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.

24. Përsa i përket denoncimit të z. B.B., i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.2021 dhe denoncimit të znj. A. I., i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 17.05.2021, duke vlerësuar në tërësi se këto denoncime nuk përmbanin fakte apo rrethana të cilat mund të përbënin provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues u shpreh për mosçeljen e hetimit gjyqësor.
25. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 dhe 53 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm të datës 19.04. 2021, për nevoja të hetimit të denoncimeve të publikut, konsideroi të nevojshme:
- a) Në lidhje me denoncimin anonim, të përcjellë në Kolegj nga Institucioni i Komisionerëve Publikë dhe i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.2021:
- (i) të kërkohet informacion dhe kopje e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në lidhje me faktin nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ndonjë rol procedural në çështjen penale në ngarkim të individit A. G.;
- (ii) të kërkohet informacion dhe kopje e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në lidhje me procedurat e hedhjes së shorteve ose caktimit të çështjeve, apo zëvendësimit të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën që subjekti i rivlerësimit ka qenë i komanduar si drejtues, dhjetor 2017 deri në momentin e largimit të tij nga kjo prokurori si drejtues i komanduar.
- b) Në lidhje me denoncimin e z. D.Z., i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.01.2020:
- (i) të kërkohet informacion nga Prokuroria e Përgjithshme nëse ka pasur ndonjë kërkesë/ankesë nga përfaqësuesi apo vetë personi i proceduar D.Z., për dërgimin për kompetencë në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të çështjes me nr. {***} të vitit 2013, që i përket individit D.Z.;
- (ii) të kërkohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kopje të akteve procedurale me të cilat çështja me nr. {***} e vitit 2013, që i përket individit D.Z., është përcjellë për kompetencë pranë kësaj prokurorie.
26. Në zbatim të kërkesave që Kolegji u ka dërguar dy prokurorive të sipërcituara, këto institucione janë përgjigjur duke dërguar informacionet përkatëse³. Nga ana e trupit gjykues, këto akte i janë përcjellë paraprakisht Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, janë administruar në cilësinë e provës dhe i janë nënshtruar gjithashtu debatit gjyqësor në seancën gjyqësore të datës 11.05.2021.
27. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 dhe 53 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm të datës 11.05. 2021, për nevoja të hetimit të denoncimit të z. D.Z., i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.01.2020, vendosi:

³Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dërguar në Kolegj informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar më datë 30.04.2021. Prokuroria e Përgjithshme është përgjigjur me informacion e dokumentacion të dërguar në datën 26.04.2020, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka kthyer përgjigje duke dërguar dokumentacion në datën 28.04.2021 dhe në datën 10.05.2021.

(i) të kërkohen nga Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, kopje të akteve dhe fletës së regjistrit në të cilin është dokumentuar përcjellja e fashikullit hetimor për çështjen me nr. {***}, të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurit D.Z., nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

(ii) të kërkohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kopje të akteve dhe fletës së regjistrit në të cilën është evidentuar ardhja e fashikullit hetimor nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, të çështjes me nr. {***}, të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurit D.Z.;

(iii) të kërkohen nga Gjykata e Apelit Vlorë, kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara në harkun kohor nga data 09.03.2015 deri më datë 16.06.2015, të çështjes që ka përfunduar me vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që i përket të pandehurit D.Z.

Trupi gjykues, në kuadër të bashkëpunimit, ftoi subjektin e rivlerësimit të japë kontributin e tij për sqarimin e fakteve dhe rrethanave të mësipërme.

28. Në zbatim të kërkesave për informacion e dokumentacion që Kolegji u ka dërguar institucioneve të sipërcituara, këto të fundit janë përgjigjur duke dërguar informacionet përkatëse⁴. Nga ana e Kolegjit, këto akte i janë përcjellë paraprakisht Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit dhe i janë nënshtruar gjithashtu debatit gjyqësor në seancën gjyqësore të datës 27.05.2021.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e ankimit të Komisionerit Publik jashtë afatit ligjor

29. Subjekti i rivlerësimit, në kundërankim dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj⁵, ka kërkuar që trupi gjykues i Kolegjit të prishë vendimin e Komisionit nr. 231/1, datë 16.06.2020, “Për pranimin e ankimit” dhe të mos pranojë ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, pasi është jashtë afatit ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

a) Komisioneri Publik ka marrë dijeni për vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit që në momentin e publikimit të vendimit të arsyetuar së bashku me mendimin e pakicës, në faqen zyrtare në internet të këtij institucioni më datë 24.03.2020. Njoftimi i publikimit të vendimit të arsyetuar nga Komisioni, në faqen e tij zyrtare në internet konsiderohet njoftim zyrtar për subjektin e rivlerësimit dhe për Komisionerin Publik, bazuar në nenet 57 e 64 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 147, 148, 162 e 163 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 52 të ligjit nr. 49/2012 e nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, Komisionerit Publik, më datë 08.04.2020, i ka përfunduar afati për të ushtruar të drejtën e ankimit.

b) Siç rezulton nga përmbajtja e vendimit nr. 231/1, datë 16.06.2020, “Për pranimin e ankimit”, Komisioneri Publik ka marrë dijeni për vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit edhe nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* të datës 24.03.2020, drejtuar

⁴Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë ka dërguar në Kolegj informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar më datë 21.05.2021 dhe 24.05.2021. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka kthyer përgjigje duke dërguar dokumentacion në datën 24.05.2021. Gjykata e Apelit Vlorë ka kthyer përgjigje duke dërguar dokumentacion në datën 26.05.2021.

⁵Në parashtrimet në seancën gjyqësore publike të zhvilluar më datë 30.03.2021, por edhe në konkluzionet përfundimtare në seancën gjyqësore publike të datës 01.06.2021.

Institucionit të Komisionerit Publik nga Komisioni, bashkëlidhur të cilit gjendet i skanuar edhe vendimi objekt ankimi.

c) Komisioneri Publik ka marrë dijëni për vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, nëpërmjet njoftimit me shkresën nr. {***}, datë 24.03.2020, të Komisionit, por nuk ka pranuar ta protokollojë atë edhe pse i ishte dërguar zyrtarisht nga Komisioni, pasi nxori një njoftim në faqen zyrtare në internet se kishte pezulluar afatet e ankimit për shkak të hyrjes në fuqi të aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020. Në kushtet kur një institucion publik është i detyruar të pranojë një akt që i njoftohet, por në fakt refuzon të dokumentojë marrjen e tij, atëherë në kuptim nenit 130, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, njoftimi konsiderohet i realizuar.

ç) Komisioneri Publik ka interpretuar në mënyrë të gabuar aktin normativ nr. 9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19” (në vijim “akti normativ nr. 9, datë 25.03.2020”), duke përfshirë në objektin e këtij akti edhe veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit, në kundërshtim me objektin e tij, me përmbajtjen e relacionit shoqërues të tij, si dhe me interpretimin që i ka bërë Ministria e Drejtësisë si organi hartues i aktit, pasi juridiksioni i organeve të rivlerësimit nuk është një juridiksion gjyqësor. Edhe në rast se akti normativ nr. 9, datë 25.03.2020, do t’u drejtohej organeve të rivlerësimit, këto organe kanë detyrimin t’u referohen drejtpërdrejt kodeve dhe ligjit nr. 84/2016, përsa u përket afateve të ankimit dhe jo aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020. Në këto kushte, që nga data 24.03.2020, afatet e ankimit kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit, nuk janë pezulluar në asnjë moment.

30. Lidhur me këtë shkak të kundërankimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik, gjatë zhvillimit të debatit gjyqësor⁶ në Kolegj, parashtrori se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara, duke prapësuar në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

a) Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se akti normativ nr. 9, datë 25.03.2020, nuk u adresohet organeve të rivlerësimit kalimtar në kushtet kur juridiksioni i rivlerësimit nuk është një juridiksion gjyqësor, nuk qëndron pasi tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar sipas së cilës Kolegji ka juridiksion gjyqësor dhe ushtron funksionet e tij si i tillë. Për rrjedhojë, veprimtaria institucionale e Kolegjit, në ushtrim të juridiksionit gjyqësor të njohur nga Kushtetuta dhe ligji, përfshihet në fushën e veprimit të aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020, dhe hyrja në fuqi e tij ka kufizuar veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë, duke pezulluar ndër të tjera dhe të gjitha afatet për paraqitjen e ankimeve.

b) Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit është paraqitur jashtë afatit ligjor, nuk qëndron, pasi nëpunësi përkatës i Komisionit ka përcjellë pranë protokollit të Institucionit të Komisionerëve Publikë, shkresën përcjellëse {***} prot., datë 24.03.2020, të Komisionit, vendimin nr. 231, datë 29.01.2020 dhe aktet përkatëse të këtij vendimi, vetëm një herë, më datë 28.05.2020, ashtu sikurse provohet nga akti “Lajmërim marrje”, nënshkruar rregullisht nga nëpunësit përkatës të dy institucioneve.

c) Komisioneri Publik vlerëson nëse vendimmarrja e Komisionit është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, vetëm pasi njihet me vendimin e Komisionit, si dhe me kopjen e dosjes me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ. Publikimi i vendimit të anonimizuar

⁶Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore publike të datës 01.04.2021.

në faqen zyrtare të Komisionit në internet, apo njoftimi i këtij vendimi në rrugë elektronike, nuk përmbush kriteret ligjore të njoftimit të vendimit, pasi në çdo rast nuk mundëson njohjen e Komisionerit Publik me aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision.

Në përfundim, Komisioneri Publik pretendoi se ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit, brenda afatit ligjor 15-ditor, të parashikuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

31. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga palët⁷ lidhur me këtë shkak të kundërankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ligji nr. 84/2016 nuk është thjesht një ligj organik që rregullon vetëm çështjet e organizimit dhe funksionimit të organeve të rivlerësimit, por ky ligj parashikon gjithashtu edhe parimet e procesit të rivlerësimit, mënyrën se si zhvillohet hetimi administrativ i të tria kriterëve të kontrollit dhe standardet e vlerësimit për secilin prej tyre, procedurën e rivlerësimit dhe seancën dëgjimore publike me subjektet e rivlerësimit, vendimmarrjen e Komisionit dhe masat disiplinore për subjektet, si dhe ushtrimin e së drejtës së ankimit në Kolegj. Pra, në tërësi, ky ligj është me natyrë procedurale.

Neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton se: *Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.* Në kushtet kur në këtë dispozitë, gjendet rregullimi i posaçëm i cili rregullon drejtpërdrejt procedurat në lidhje me institutin e ankimit kundër vendimit të Komisionit, trupi gjykues çmon se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, nuk gjen zbatim neni 4, pika 6 e po këtij ligji, në të cilën parashikohet: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.*

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 është dispozita e zbatueshme që rregullon institutin e ankimit kundër vendimit të Komisionit.

32. Nga analiza e nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton që vendimet e Komisionit, mund të ankimohen nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda një afati 15-ditor, duke filluar ky afat nga dita e komunikimit të vendimit të Komisionit. Në rastin konkret, me qëllim shqyrtimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me verifikimin e respektimit të afatit të ankimit nga ana e Komisionerit Publik, trupi gjykues nga verifikimi i akteve, të cilat përbëjnë dosjen e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, konstaton se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.03.2020, i ka njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, ku sipas lajmërim-marrjes së nënshkruar nga nëpunësit përkatës të dy institucioneve, rezulton se është marrë në dorëzim më datë 28.05.2020, ora 15:10. Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.03.2020, Komisioni i ka njoftuar subjektit të rivlerësimit vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, ku sipas dëftesës postare, si

⁷Subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore publike të datës 30.03.2021, kërkoi nga trupi gjykues i Kolegjit shqyrtimin paraprakisht të kërkesës së tij përprishjen e vendimit të Komisionit nr. 231/1, datë 16.06.2020, "Për pranimin e ankimit" dhe mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit. Trupi gjykues i Kolegjit, në seancën gjyqësore të së njëjtës datë, me vendim të ndërmjetëm, vlerësoi se në nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile nuk parashikohet ankim ndaj vendimit të Komisionit që ka pranuar ankimin e Komisionerit Publik. Në këto kushte, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë edhe parashikimin e pikës 3 të nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të trajtojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit në kuadër të vlerësimit tërësor të ankimit të Komisionerit Publik. (Shih procesverbalin e seancës gjyqësore publike, datë 30.03.2021.)

datë e dorëzimit të akteve nga shërbimi postar te subjekti i rivlerësimit, është data 27.03.2020. Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.03.2020, Komisioni i ka njoftuar Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”) vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, ku sipas lajmërim-marrjes të nënshkruar nga nëpunësit përkatës të dy institucioneve, rezulton se është marrë në dorëzim më datë 07.04.2020, ora 08:50.

Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 10.06.2020, me shkresën nr. {***} prot., ka paraqitur pranë Komisionit “Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit Anton Martini”. Komisioni, më datë 16.06.2020, ka marrë vendimin nr. 231/1 “Për pranimin e ankimit”. Ky vendim i është njoftuar Komisionerit Publik, ONM-së dhe subjektit të rivlerësimit. Ky i fundit ka marrë dijeni për këtë vendim më datë 17.06.2020. Më datë 22.06.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit aktin “Ankim”⁸, me objekt:

“1. Prishjen e vendimit nr. 231/1, datë 16.06.2020, të KPK-së. 2. Mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të KPK-së, shpallur në faqen zyrtare www.kpk.al dhe komunikuar palëve më datë 24.03.2020”.

33. Nga situata faktike e pasqyruar më sipër, trupi gjykues vëren se me shkresën nr. {***}, datë 24.03.2020, Komisioni i ka dërguar Komisionerit Publik njoftimin e vendimit nr. 231 datë 29.01.2020, por në dosjen e përcjellë nga Komisioni në Kolegj nuk ekziston asnjë akt zyrtar që konfirmon marrjen dijeni të Komisionerit Publik në datën 24.03.2020, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

Nga akti lajmërim-marrje, rezulton se Komisioneri Publik ka marrë dijeni në datën 28.05.2020, për vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit. Të njëjtin fakt ka pranuar edhe Komisioni në vendimin nr. 231/1, datë 16.06.2020, në të cilin shprehet se i ka ridërguar Institucionit të Komisionerëve Publikë shkresën nr. {***}, datë 24.03.2020, në datën 28.05.2020. Në këto kushte, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se nuk gjen zbatim paragrafi i gjashtë i nenit 130 të Kodit të Procedurës Civile⁹.

Trupi gjykues vlerëson se sipas nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, njoftimi i vendimit konsiderohet i përmbushur nëse plotësohen dy kushte kumulative: dërgimi i njoftimit dhe marrja dijeni nga ana e Komisionerit Publik [ose subjektit të rivlerësimit] të cilit i drejtohet njoftimi. Vetëm dërgimi i njoftimit nga ana e Komisionit, pa konfirmimin e marrjes dijeni të Komisionerit Publik, nuk mjafton për ta konsideruar të njoftuar këtë të fundit, pasi procedura e njoftimit konsiderohet ligjërisht e realizuar me marrjen dijeni zyrtarisht nga ana e Komisionerit Publik. Në kushtet kur provohet se Komisioneri Publik nuk e ka marrë në dorëzim nëpërmjet protokollit zyrtar, shkresën nr. {***} prot., datë 24.03.2020, njoftimi nuk mund të konsiderohet i përfunduar në këtë datë, për rrjedhim, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, afati 15-ditor i ankimit nuk ka filluar të ecë nga data 24.03.2020.

34. Përsa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Institucioni i Komisionerëve Publikë ka refuzuar të protokollojë shkresën nr. {***}, datë 24.03.2020, të Komisionit, me anë të së cilës i është komunikuar fillimisht vendimi nr. 231, datë 29.01.2020, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim mbetet i paprovuar, pasi në dosjen e rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj nuk ekziston asnjë provë që të mbështesë këtë pretendim dhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për këtë qëllim.

⁸ Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 22.06.2020.

⁹Neni 130, paragrafi i gjashtë i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në qoftë se personi të cilit i drejtohet njoftimi refuzon marrjen e njoftimit, nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, punonjësi i gjykatës ose punonjësi i shërbimit postar bën shënimin përkatës në aktin objekt njoftimi dhe, kur është e mundur, e vërteton edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer”. Shih në linkun: <https://qbz.gov.al/preview/63ca3bd6-ed1c-42d4-a44f-05c970f7714d>.

35. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, se Komisioneri Publik është jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankimit, për shkak se ka marrë dijeni për vendimin e arsyetuar nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit, në datën 24.03.2020, nëpërmjet publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare në internet të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se detyrimi i Komisionit për të publikuar vendimin përfundimtar për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, buron nga neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se: *Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.*

Nga interpretimi literal i dispozitës së mësipërme, rezulton se publikimi i vendimit nga ana e Komisionit në faqen zyrtare në internet, nuk përbën një nga format e njoftimit për subjektin e rivlerësimit, për Komisionerin Publik dhe për vëzhguesit ndërkombëtarë. Procesi i publikimit të vendimit në faqen zyrtare në internet të Komisionit, nuk prezumon njoftimin e pjesëmarrësve në procesin e rivlerësimit, pasi dispozita e sipërcituar, në mënyrë të shprehur, kërkon që vendimi me shkrim, në të cilin janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, ashtu siç është parashikuar në pikën 1 të nenit 57¹⁰ të po këtij ligji, t'i njoftohet drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë. Qëllimi i dispozitave të sipërcituara është që subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe Vëzhguesve Ndërkombëtarë t'u njoftohet vendimmarrja e Komisionit në formën e aktit të shkruar, i cili duhet të njoftohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe substanciale, të cilat garantojnë marrjen dijeni të tyre për këtë akt. Njohja e subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik me vendimin me shkrim të Komisionit, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësim të trupit gjykues, publikimi i vendimit në faqen zyrtare në internet të Komisionit nuk ka vlerë të posaçme për efekt të njoftimit të subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, pasi është një mjet që nuk garanton në asnjë rast marrjen dijeni të tyre për publikimin e vendimit dhe aq më tepër nuk garanton njohjen me përmbajtjen e plotë të tij, qoftë edhe vetëm për faktin se të dhënat e pasqyruara në të janë të anonimizuara. Në rastin e Komisionerit Publik, vendimi duhet të jetë i shoqëruar edhe me dosjen e plotë të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, në mënyrë që Komisioneri Publik të ushtrojë kompetencën kushtetuese të ushtrimit të ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në mënyrë efektive, pas njohjes me aktet dhe provat e administruara nga ana e Komisionit, pasi nuk është palë procedurale në asnjë fazë të zhvillimit të hetimit dhe shqyrtimit të çështjes në Komision. Publikimi i vendimit në faqen zyrtare në internet i shërben njohjes së publikut me vendimmarrjen e Komisionit për një subjekt rivlerësimi, në funksion të realizimit të qëllimit të shpallur në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Në kushtet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se data e publikimit të vendimit të Komisionit në faqen zyrtare të tij në internet nuk mund të konsiderohet si datë e njoftimit të vendimit për efekt të llogaritjes së afatit të ankimit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se afati i ankimit ka filluar që në datë 24.03.2020, për shkak të publikimit të vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit në faqen zyrtare në internet në këtë datë, nuk është i bazuar.

36. Trupi gjykues e gjen të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit Komisioneri Publik ka marrë dijeni për vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit edhe nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* të datës 24.03.2020, për arsyet në vijim.

¹⁰Neni 57, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: "1. Relatori i çështjes arsyeton me shkrim vendimin e Komisionit".

Mënyrat e komunikimit gjatë procesit të rivlerësimit, përfshirë edhe njoftimin e vendimit përfundimtar, rregullohen nga vetë ligji i posaçëm nr. 84/2016. Sipas nenit 46 të këtij ligji¹¹, komunikimet dhe njoftimet nëpërmjet postës elektronike përcaktohen si mënyra komunikimi të organeve të rivlerësimit me subjektet e rivlerësimit, me qëllim lehtësimin e këtij procesi. Vetëm përsa i përket subjektit të rivlerësimit, ligji ka përcaktuar postën elektronike si mënyrë primare të komunikimeve dhe njoftimeve, ndërsa në lidhje me komunikimin ndërinstitucional të organeve të rivlerësimit mes tyre, ligji nuk e përmban një parashikim të tillë.

Realizimi i njoftimit nëpërmjet mjeteve elektronike rregullohet nga neni 156 i Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se: *Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi.* Dispozita e mësipërme është e aplikueshme vetëm në ato raste kur pala që merr njoftimin, pranon dhe jep pëlqimin në mënyrë të shprehur që komunikimi i njoftimeve do të bëhet në formë elektronike.

Në zbatim të kësaj dispozite në rastin konkret, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendimin nr. 231/1, datë 16.06.2020, “Për pranimin e ankimit”, ka shpjeguar se ndërmjet tij dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë është zhvilluar një komunikim elektronik në datën 13.03.2020, ku ky i fundit njofton Komisionin se: *Në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga Covid-19, Institucioni i Komisionerëve Publikë njofton kufizimin e mëtejshëm të veprimtarisë institucionale dhe dërgimin e punonjësve në shtëpi, deri në një njoftim të dytë zyrtar. Në vijim, prej datës 12 mars, Komisionerët Publikë do të vazhdojnë shqyrtimin e 7 vendimeve të njoftuara nga Komisioni, të cilat janë në proces. Veprimtaria e institucionit do të vazhdojë të kryhet në ato funksione/detyra/njësi organizative që mund të përmbushen në kushtet e banesës nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar.* Nga përmbajtja e komunikimit të mësipërm, rezulton që Institucioni i Komisionerëve Publikë nuk ka dhënë pëlqimin që njoftimi i vendimeve përfundimtare që do të dalin nga Komisioni, gjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19, do të bëhet në rrugë elektronike. Një fakt i tillë është pranuar edhe nga Komisioni, i cili është organi që ka nxjerrë vendimin nr. 231, datë 29.01.2020, ka kryer njoftimin e vendimit dhe me këtë rast ka kryer dhe komunikimet me Institucionin e Komisionerëve Publikë, pasi me vendimin nr. 231/1, datë 16.06.2020, ka pranuar ankimin e Komisionerit Publik si ankim i ushtruar brenda afatit ligjor 15-ditor¹².

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se njoftimi i vendimit nr. 231, datë 20.01.2020, për Komisionerin Publik, nuk konsiderohet i realizuar më datë 24.03.2020 e si rezultat, nuk mund të konsiderohet se afati i ankimit fillon të përlllogaritet nga kjo datë.

37. Nga verifikimi i akteve të dosjes së rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj¹³, trupi gjykues konstaton se Komisioneri Publik ka marrë dijeni për vendimin nr. 231, datë 29.01.2020,

¹¹Neni 46 i ligjit nr.84/2016 përcakton se:

“1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji.

3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit.

4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.”

¹²Në vendimin nr. 231/1, datë 16.06.2020, Komisioni shprehet: “Trupi gjykues gjykon se ky ankim është në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që do të thotë se ankimi është bërë 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit, i cili për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, është marrë në dorëzim nga Komisioneri Publik më datë 28.05.2020 dhe plotëson kushtet e parashikuara në nenin 46 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2021, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹³Sipas përmbajtjes së dëftesës postare të përshkruar në paragrafin 32 më sipër në këtë vendim.

më datë 28.05.2020. Në datën 10.06.2020, Komisioneri Publik ka paraqitur ankim pranë Komisionit, kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit, ditën e trembëdhjetë nga dita e komunikimit të vendimit, pra brenda afatit ligjor, sipas kërkesave të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

38. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioneri Publik ka interpretuar në mënyrë të gabuar aktin normativ nr. 9, datë 25.03.2020, duke përfshirë në objektin e këtij akti edhe veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit, në kundërshtim me objektin e tij, me përmbajtjen e relacionit shoqërues të tij, si dhe me interpretimin që i ka bërë Ministria e Drejtësisë si organi hartues i aktit, pasi juridiksioni i organeve të rivlerësimit nuk është një juridiksion gjyqësor, trupi gjykues vëren se për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e Covid-19, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid -19”¹⁴, në nenin 3 të të cilit përcaktohet se: *Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.* Sipas përcaktimit të nenit 5, ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare¹⁵. Bazuar në sa më sipër, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka pezulluar të gjitha afatet për paraqitjen e ankimeve deri më datë 28.05.2020, kur në zbatim të aktit normativ nr. 21, datë 27.05.2020, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr. 30/2020”¹⁶ ka rifilluar veprimtarinë në kryerjen e funksioneve institucionale.
39. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të sipërcituar, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës¹⁷ dhe nenin 65 të ligjit nr. 84/2016¹⁸, Komisioneri Publik është palë në procesin gjyqësor që zhvillohet në Kolegj. Juridiksioni gjyqësor i Kolegjit, si i vetmi organ gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, është parashikuar në pikën 1 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës¹⁹ dhe është

¹⁴Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 30/2020, më datë 16.04.2020, shih linkun:

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/04/16/30/4a8fc580-ca86-43b0-8429-88ad1ca2ceb>.

¹⁵Shih linkun: <https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/03/25/9>.

¹⁶Botuar në Fletoren Zyrtare, shih linkun: <https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/05/27/21>, dhe miratuar me ligjin nr. 75/2020 të Kuvendit të Shqipërisë, shih linkun: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/06/25/75/7c28046c-bc73-4017-aace-76bebd922888>.

¹⁷Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës përcakton: “5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese.[...]”.

¹⁸Neni 65 i ligjit nr. 84/2016¹⁸ parashikon se: “1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51, dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. 2. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. 3. Në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Apelit e gjykon çështjen në seancë publike”.

¹⁹Neni F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës përcakton: “1. Kolegji i Apelit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjyqësore me pesë anëtarë secili”.

konfirmuar nga qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017²⁰ dhe nga qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë²¹.

Në bazë të pikës 2 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji, si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, e ushtron veprimtarinë duke garantuar të drejtën e ankimit, si nga pikëpamja e fakteve dhe provave, ashtu dhe nga pikëpamja e zbatimit të të drejtave kushtetuese e parimeve të procesit të rregullt ligjor, sipas parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Referuar sa më sipër, Kolegji, duke qenë gjykata e vetme për juridiksionin e rivlerësimit, nuk mund të përjashtohet nga zbatimi i aktit normativ.

Në kushtet kur veprimtaria e Institucionit të Komisionerëve Publikë, në përmbushje të detyrimit kushtetues e ligjor të ushtrimit të së drejtës së ankimit, është e ndërlikuar ngushtësisht dhe e ndërvarur nga veprimtaria e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se pezullimi i afateve të ankimeve i parashikuar në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 24.03.2020, i shtriu efektet edhe në afatet për paraqitjen e ankimeve të Komisionerëve Publikë ndaj vendimeve të Komisionit, para Kolegjit.

40. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit është paraqitur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të gabuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit në kundërankim dhe, për rrjedhojë, të pabazuar në ligj.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

41. Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit konkluzionet e Komisionit në lidhje me pagesën e vlerës së pasurisë apartament banimi me sipërfaqe banimi 97,16 m², sipërfaqe të përbashkët 10,74 m², sipërfaqe tarrace 25,95 m², si dhe një post garazhi, në rrugën “{***}” në Tiranë, janë në kundërshtim me përmbajtjen e provave të administruara, pasi subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
42. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim:[...] në kushtet kur: (i) nuk evidentohet pagesë tjetër e kryer nga subjekti; (ii) nuk i ka kaluar në pronësi pasuria e llojit garazh; si dhe (iii) palët me vullnetin e tyre të plotë kanë deklaruar se shuma prej 5.000 eurosh nuk është paguar ende – Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse dhe të provuara për pagesën e kryer deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së llojit apartament banimi dhe vlerën e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë. Për më tepër, Komisioni vëren se në datën 26.01.2017 (rreth 13 ditë pas kryerjes së pagesës së kësaj të dytë), me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit

²⁰Në vendimin nr. 2/2017, paragrafi 63, Gjykata Kushtetuese është shprehur: “Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera”.

²¹Në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, 9 shkurt 2021, në paragrafin 288, GjEDNj është shprehur: “Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK-ja ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit {***}. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj”.

kalimtar “vetting” (shtojca 2) në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon vlerën prej 800.000 lekësh si gjendje cash, për të cilën u provua se ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e kësaj shume. Në këtë këndvështrim, nisur dhe nga fakti se rezultoi e provuar se noterja në përpilimin e kontratës së shitblerjes ka bërë edhe gabime të tjera materiale, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka deklaruar marrëdhënien faktike lidhur me shumën e paguar për shoqërinë ndërtuese. Komisioni vëren se subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, por vlerëson se kjo mund të ketë ardhur si rezultat i faktit se kjo kontratë është përpiluar nga e njëjta notere, e cila ka përpiluar kontratën e porosisë, sipas së cilës parashikohej kalimi në pronësi të subjektit i dy pasurive (apartamentit dhe garazhit), kundrejt pagesës prej 90.000 eurosh²².

43. Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit me pretendimin se ky i fundit, në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me pagesën e vlerës së pasurisë apartament banimi me sipërfaqe banimi 97,16 m², sipërfaqe të përbashkët 10,74 m², sipërfaqe tarrace 25,95 m², si dhe një post garazhi, në rrugën “{***}” në Tiranë (në vijim “apartamenti”) në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes për këtë pasuri. Komisioneri Publik argumentoi se sipas kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, të datës 17.07.2017, rezulton se është paguar vlera prej 90.000 eurosh, ndërsa në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si detyrim të mbetur ndaj shitësit shumën prej 5.000 eurosh, duke u përpjekur të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë, e cila përbën provë të plotë.
44. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, parashtroi se ekziston vetëm një kontratë për shitblerjen e pasurisë “apartament”, ajo me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.07.2017. Është gabim i noteres lidhur me deklarimin e pagesës së plotë prej 90.000 eurosh në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ashtu si dhe ajo vetë e ka pranuar në deklaratën noteriale të hartuar prej saj me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2019. Subjekti i rivlerësimit, në asnjë deklaram të tijin, nuk është shprehur lidhur me pagimin e plotë të vlerës prej 90.000 eurosh, pasi ende edhe sot nuk i ka kaluar në pronësi posti i parkingut, arsye për të cilën ai nuk ka paguar vlerën prej 5.000 eurosh. Për rrjedhojë, në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes, subjekti i rivlerësimit ka paguar vetëm sasinë prej 85.000 eurosh për blerjen e apartamentit.
45. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, sa i takon ekzistencës apo jo të mospërputhjeve në deklaramet e subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e paguar për pasurinë “apartament”, trupi gjykues konstaton në mënyrë të përmbledhur, sa vijon.
- 45.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit²³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi me adresë rruga “{***}”, pallati “{***}”, ap. nr. {***}, Tiranë, me sipërfaqe banimi 97,16 m², sipërfaqe të përbashkët 10,74 m², sipërfaqe tarrace 25,95 m², si dhe një post garazhi, me vlerë totale 90.000 euro.* *Kjo banesë akoma nuk është regjistruar në ZVRPP në emrin tim, por me kontratën e porosisë, datë 14.04.2015, bërë te notere G. B., me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., kam porositur këtë banesë, ku paraprakisht në momentin e hartimit të kësaj kontrate, kam paguar cash te ndërtuesi, në prani të noteres, shumën prej 50.000 eurosh. Më pas, më datë 13.01.2017, kam derdhur në llogarinë e firmës ndërtuese, pranë bankës Tirana Bank shumën prej 35.000 eurosh. I mbetem për t’i paguar në momentin e kalimit të pronësisë së objektit edhe një shumë tjetër prej 5.000 eurosh.*

²² Paragrafët 27.27-27.29 të vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit.

²³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 26.01.2017.

Vlera e deklaruar: 85.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Shpenzime arredimi të banesës në vlerën 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%

Burimi i të ardhurave për blerjen e apartamentit dhe arredimin e shtëpisë janë:

- a. *kredia e marrë nga Raiffeisen Bank ShA në shumën prej 5.000.000 lekësh në vitin 2007, me afat shlyerje 25 vjet;*
- b. *kredia e marrë sërish nga Raiffeisen Bank ShA, në shumën prej 5.200.000 lekësh në vitin 2016, me afat shlyerje 15 vjet;*
- c. *të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga puna jonë ndër vite.*

45.2. Bashkëlidhur deklaratës së mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2015, të lidhur mes tij dhe shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, me objekt porositjen nga ana e subjektit të rivlerësimit të apartamentit të banimit nr. {***}, me sipërfaqe 97,16 m², sipërfaqe të përbashkët 10,74 m², sipërfaqe tarrace 25,95 m², si dhe një post garazhi, për çmimin prej 90.000 eurosh, i cili sipas nenit 4 të kësaj kontrate, do të likuidohej tërësisht jashtë zyrës noteriale sipas kësteve: “1. Deri në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate ka paguar për llogari të shoqërisë së ndërtimit këstin prej 50.000 eurosh. 2. Pjesa e mbetur 40.000 euro do të paguhet me marrëveshje mes palëve, e ndarë në këste deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes mes palëve”.

45.3. Për të vërtetuar kryerjen e pagesave të kësteve sipas deklaramit të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision dokumentacionin për pagesat e kryera ndaj shoqërisë ndërtuese:

- (i) mandatarkëtim nr. {***}, datë 07.04.2015, shuma 50.000 euro, me përshkrim blerje apartamenti. Mandati mban vulën e shoqërisë “{***}” ShPK dhe nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit, marrësit A. H. dhe arkëtarit. Përshkrimi i këtij mandatarkëtimi përputhet me parashikimin e kontratës së porosisë sipas së cilës, deri në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, porositësi ka paguar jashtë zyrës noteriale, për llogari të shoqërisë së ndërtimit, këstin prej 50.000 eurosh;
- (ii) mandat bankar depozite në arkë, për pagesën prej 35.000 eurosh, datë 13.01.2017, derdhur në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në Tirana Bank, me përshkrim “Blerje apartamenti sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol.”, depozitim i kryer nga subjekti i rivlerësimit.

45.4. Nga informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Tiranë²⁴, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe 97,16 m², regjistruar në bazë të kontratës së shitblerjes, lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit dhe z. Anton Martini, në cilësinë e blerësit, e cila është pjesë e praktikës së regjistrimit të pasurisë. Në këtë kontratë vërehet se noteri ka bërë korrigjime të gabimeve materiale, duke korrigjuar datën e kontratës dhe numrin e pasurisë, korrigjime të shoqëruara me vulën e noterit [veprim i lejuar sipas nenit 56 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, ligji në fuqi për kohën kur është bërë korrigjimi i këtij akti].

45.5. Sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë “apartament” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.07.2017, neneve 2 dhe 5 të saj, rezulton se këtë pasuri pala blerëse e ka përfituar nga pala shitëse, sipas kushteve të kontratës noteriale së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2015, duke paguar blerësi – subjekti i rivlerësimit – vlerën totale të shitblerjes prej 90.000 eurosh, sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë²⁵.

²⁴Informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.05.2018.

²⁵Në nenin 2, me titull “Çmimi i shitjes”, të kontratës së shitblerjes së pasurisë, përcaktohet shprehimisht se: “Çmimi i shitjes së pasurive të paluajtshme të pasurisë së sipërcituar, është 90.000 euro, të paguara sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2015”.

45.6. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim e ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato të dhëna gjatë gjykimit në Kolegj. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratat noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2019 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2019, ku në cilësinë e deklaruesve janë subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. H. Referuar këtyre deklaratave noteriale, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë konfirmon problematikën lidhur me kalimin e pronësisë të pasurisë së llojit garazh në favor të subjektit të rivlerësimit, si dhe faktin që ka mbetur pa u paguar shuma prej 5.000 eurosh, shumë e cila do të paguhej si këst i fundit në momentin e kalimit të pronësisë.

46. Në vlerësim të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se në të dhënat e deklaruara lidhur me vlerën e paguar për pasurinë në fjalë, ekzistojnë mospërputhje mes deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në Komision dhe akteve të administruara nga ky i fundit gjatë hetimit administrativ, pasi gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka paguar vlerën prej 85.000 eurosh deri në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.07.2017, ndërsa në të njëjtën kontratë palët kanë deklaruar me vullnet të plotë se në favor të shoqërisë “{***}” ShPK është paguar nga subjekti i rivlerësimit shuma 90.000 euro. Sipas kësaj kontrate, marrëdhënia juridike e sipërmarrjes e krijuar mes palëve në vitin 2015 për porositjen e një apartamenti dhe një posti garazhi, është konkretizuar nëpërmjet kontratës së shitjes në vijim, me kalimin e pronësisë subjektit të rivlerësimit, në vitin 2017, vetëm të pasurisë “apartament”, pasi ishte shlyer çmimi përkatës prej 90.000 eurosh.
47. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “{***}” ShPK në deklaratat noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2019 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2019, për të kundërshtuar kontratën e shitblerjes të lidhur me vullnetin e tyre të plotë para noterit në vitin 2017, nuk arrijnë ta bindin trupin gjykues mbi ekzistencën e pretenduar të dakordësisë së palëve për pagesën në vlerën 85.000 euro, në momentin e lidhjes së kontratës. Edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se konfirmimi në kontratën e shitblerjes së pasurisë për pagimin e vlerës 90.000 euro është një gabim i noterit publik, nuk arrijnë të bindin trupin gjykues, përse kohë në kontratën e shitblerjes në fjalë janë kryer disa korrigjime të gabimeve materiale nga noteri publik, ndërsa vlera 90.000 euro nuk ka qenë objekt korrigjimi. Për rrjedhojë, referuar nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj” dhe nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”, kontrata noteriale e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.07.2017, për pasurinë “apartament”, përbën provë të plotë në lidhje me pagimin e vlerës 90.000 euro për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit.
48. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i Komisionerit Publik, se Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me pagesën e vlerës së pasurisë “apartament” në momentin

*Ndërsa në nenin 5 të saj, me titull “Mënyrat dhe afatet e pagesës së çmimit”, përcaktohet se: “Mënyra e pagesës së çmimit të shitjes të pronës së përshkruar sa më sipër në këtë kontratë, do të jetë ajo e respektimit të kushteve dhe afateve sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2015”.*

e lidhjes së kontratës së shitblerjes për këtë pasuri në vitin 2017, është një pretendim i drejtë, pasi Komisioni është mbështetur vetëm në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe jo në përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë “apartament”, e cila përbën provë të plotë. Pavarësisht këtij vlerësimi të derivuar nga shkaku i ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues thekson se sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike dhe atë të rivlerësimit, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë saktësisht dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të. Për rrjedhojë, duke qenë se në rastin konkret, objekt shqyrtimi ishte deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, në lidhje me vlerën e paguar për pasurinë “apartament”, mospërputhja e këtij deklarimi me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë në fjalë, nuk sjell asnjë pasojë në lidhje me kontrollin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, për shkak se ky deklarim nuk është bërë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban parasysh gjithashtu, se në analizë të të gjitha rrethanave që lidhen me këtë situatë faktike e ligjore, të pasqyruara në mënyrë të hollësishme në paragrafët më sipër²⁶ në këtë vendim, rezulton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se ka paguar vlerën prej 85.000 euroshderi më datë 26.01.2017, datë e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit për pasurinë “apartament” sipas kontratës së porosisë, është deklarim i saktë.

49. Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit, *shuma prej 37.400 eurosh që rrjedh nga depozitimet në Raiffeisen Invest në vitet 2010-2011, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur me burim fillestar kredinë e marrë në Bankën Raiffeisen në vitin 2007, nuk justifikohet me burime të ligjshme, për pasojë, dhe kësti i parë i paguar për pasurinë apartament, trupi gjykues konstaton si më poshtë.*

Komisioni, në vlerësimin dhe kontrollin e burimit të krijimit të pasurisë “apartament”, shprehet në vendim²⁷: *Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka zbatuar detyrimin ligjor për deklarimin e shumës së përfutur nga kredia si detyrim financiar në Raiffeisen Bank, në rubrikën e deklarimit të detyrimeve ndaj personave fizikë e juridikë, për pasojë, kjo shumë nuk do të duhej të deklarohej dhe në rubrikën e ndryshimit të pasurive, duke qenë se subjekti e kishte deklaruar marrëdhënien ligjore me të. Për më tepër, në rubrikën e shtesave dhe ndryshimeve në formularët e deklaratimeve periodike pasqyrohen pasuritë në pronësi dhe në përdorim dhe jo ato që raportohen si detyrime ndaj të tretëve. Si rrjedhim, Komisioni bazuar mbi prova, krijoi bindjen se shuma prej 37.400 eurosh, e përfutur nga mbyllja e fondit në Raiffeisen Invest në vitin 2015, të cilën subjekti e deklaroi si burim krijimi të pasurisë së tij, rrjedh nga kredia në shumën prej 5.000.000 lekësh, në vitin 2007, në Raiffeisen Bank.*

50. Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, parashtroi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në deklaratimet e interesave privatë të viteve 2007-2010, nuk kanë deklaruar posedimin e likuiditeteve *cash* të tërhequra nga llogaria e kredisë gjatë viteve 2007 dhe 2008, në vlerën 5.000.000 lekë. Nisur nga vlera provuese që marrin deklaratimet vjetore, në referencë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmoi se subjekti i rivlerësimit, në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, kishte detyrimin të deklaronte vlerën e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, si dhe çdo ndryshim të tyre. Në vijim të këtij interpretimi ligjor, Komisioneri Publik pretendoi se shuma prej 37.400 eurosh, që rrjedh nga

²⁶ Shih paragrafin 45 të këtij vendimi.

²⁷ Paragrafi 29 i vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit.

depozitimet në Raiffeisen Invest në vitet 2010-2011, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur me burim fillestar kredinë e marrë në janar 2007 në Raiffeisen Bank, nuk justifikohet me burime të ligjshme. Në këto kushte, Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së kështit të parë të apartamentit, me të ardhura nga kredia me kushte lehtësuese e marrë në vitin 2007.

51. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në kundërshtim të pretendimeve të Komisionerit Publik, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se për pagesën e kështit të parë të pasurisë “apartament”, bashkëshortja e tij tërhoqi deri në datën 07.04.2015, sasinë prej 27.000 eurosh nga fondi i investimit në Raiffeisen Invest dhe me kursimet që ndodheshin *cash* në shtëpi, në të njëjtën datë, bashkëshortët i paguan shoqërisë sipërmarrëse sasinë prej 50.000 eurosh, sipas mandatarëkëtimit përkatës. Deklarimi i tij në deklaratën e vitit 2015 nuk është i pasaktë, pasi subjekti i rivlerësimit është shprehur në çdo deklarim të tij, se shuma prej 50.000 eurosh, e paguar më datë 07.04.2015, është rezultat i shumës prej 37.400 eurosh që bashkëshortët kishin të depozituar në bankë dhe sasisë së parave *cash* që kishin në shtëpi, pavarësisht se më datë 07.04.2015, ata harxhuan më shumë nga paratë *cash* që kishin në shtëpi, për të mbuluar shumën prej 23.000 eurosh, por parave *cash* në shtëpi për pak ditë u shtuan sasinë prej 10.600 eurosh, të tërhequra nga Raiffeisen Invest pas datës 07.04.2015. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratimet periodike vjetore në vitet 2007 dhe 2008 të shumave të tërhequra nga llogaritë bankare, subjekti i rivlerësimit parashtron se ndër vite ka deklaruar vetëm shtesat e pasurisë të krijuara në vitin përkatës dhe jo totale të parave *cash* në shtëpi, pasi kështu e ka konceptuar mënyrën e deklarimit në rubrikën përkatëse të deklaratës periodike të pasurisë. Në deklaratën e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga kredia e marrë në janar të këtij viti, gjysma e saj, në vlerën 2.500.000 lekë, është depozituar nga bashkëshortja në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, duke presupozuar se gjysma tjetër ka qenë *cash* në shtëpi. Në vitin 2008, është tërhequr nga Banka e Shqipërisë shuma prej 2.495.000 lekësh, të cilën subjekti e ka mbajtur gjendje *cash* në shtëpi. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se fakti që këto dy shuma kanë qenë gjendje *cash* në shtëpi, është provuar gjithashtu edhe me deklarimin sqarues që ai ka bërë pranë ILDKPKI-së më datë 03.05.2012, me dokumentin e emërtuar “Shtesë për deklaratën e interesave privatëperiodikë vjetorë për vitin 2011”.
52. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupë gjykues konstaton si vijon.

52.1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar si burim të të ardhurave për blerjen e apartamentit dhe mobilimin e tij, kreditë bankare pranë Raiffeisen Bank në vitin 2007, në vlerën 5.000.000 lekë dhe në vitin 2016, në vlerën 5.200.000 lekë, si dhe të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes ndër vite²⁸.

52.2. Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank²⁹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, ka lidhur me këtë bankë kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2007, me objekt kredidhënie në vlerën 5.000.000 lekë, me afat shlyerjeje 25 vjet, me qëllim blerje apartamenti.

Referuar të dhënave në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në Raiffeisen Bank, rezulton se:

- më datë 09.03.2007, në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit është disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë;

²⁸ Shih paragrafin 45.1 të këtij vendimi.

²⁹ Informacioni i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2019.

- më datë 11.04.2007, shuma 5.000.000 lekë transferohet nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit te llogaria e pagës së bashkëshortes së tij;
- më datë 13.04.2007, shuma 5.003.500 lekë transferohet nga llogaria e pagës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë Bankës së Shqipërisë, për t'u investuar në bono thesari.

Banka e Shqipërisë ka informuar Komisionin³⁰ se në periudhën 19.04.2007 - 16.10.2008, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. H. M., ka blerë bono thesari³¹ dhe ka kryer veprime financiare në lidhje me to³², si rezultat i të cilave gjendja e bonove të thesarit, më datë 31.12.2007 ka qenë 2.500.000 lekë dhe më datë 31.12.2008 ka qenë 0 lekë.

52.3. Në deklaratën e interesave privatë vjetorë të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredia e marrë për strehim në janar 2007, për shkak të mospërdorimit të menjëhershëm, është depozituar nga bashkëshortja në Bankën e Shqipërisë, nën titullin bono thesari (afati 6-mujor), vlera 156.000 lekë³³. Gjysma e kredisë në vlerën 2.500.000 lekë është depozituar sërish nga bashkëshortja në nëntor 2007 në Bankën e Shqipërisë, nën titullin bono thesari (afati 6-mujor), vlera 72.000 lekë³⁴.*

52.4. Në deklaratën e interesave privatë vjetorë të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kredia e marrë për strehim në janar 2007, për shkak të mospërdorimit të menjëhershëm, është depozituar nga bashkëshortja në Bankën e Shqipërisë, nën titullin bono thesari (afati 6-mujor), vlera 156.000 lekë.*

52.5. Në deklaratën e interesave privatë vjetorë të vitit 2010 ka deklaruar: *Kam kursyer nga rroga ime vjetore dhe e bashkëshortes një sasi prej 700.000 lekësh, të cilat, pasi i kemi konvertuar në euro, i kemi depozituar në emrin e bashkëshortes sime në Bankën Raiffeisen. Vlera 5.000 euro.*

Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, rezulton se shuma prej 5.000 eurosh është derdhur nga bashkëshortja e subjektit në datën 16.04.2010, me përshkrimin “Derdh H. M.”, pa specifikuar burimin nga vinte kjo shumë. Në datën 28.07.2011, me përshkrimin “Derdh nga kredia”, bashkëshortja e subjektit ka derdhur në po në të njëjtën llogari, shumën 28.000 euro.

52.6. Bashkëlidhur deklaratës së interesave privatë vjetorë të vitit 2011, gjendet një shkresë e datës 03.05.2012, e deklaruesit Anton Martini, me titull “Shtesë për deklaratën e interesave privatëperiodikë/vjetorë për vitin 2011”, në të cilën subjekti i rivlerësimit është shprehur se në deklaratën e vitit 2011, nuk ka shënuar se një pjesë të kredisë së marrë në Raiffeisen Bank për qëllim strehimi në vitin 2007, e ka konvertuar në vlerën 33.000 euro. Këtë shumë, në pritje të investimit për shtëpi, në datë 28.07.2011, bashkëshortja e tij e ka depozituar pranë Raiffeisen

³⁰Informacion i përcjellë në Komision nga Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.04.2018.

³¹Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë në periudhën:

- 19.04.2007-19.07.2007, bono thesari me afat tremujor, në vlerën 500.000 lekë;
- 26.04.2007- 25.10.2007, bono thesari me afat 6-mujor, në vlerën 4.500.000 lekë;
- 25.10.2007 -24.04.2008, bono thesari (rivendosje me afat 6-mujor), në vlerën 2.500.000 lekë;
- 24.04.2008-16.10.2008, bono thesari me afat 6-mujor, në vlerën 2.500.000 lekë.

³²Veprimet e kryera me bonot e thesarit nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, janë si vijojnë: më datë 19.07.2007, pas maturimit, në llogarinë e pagës është transferuar shuma 498.792 lekë; më datë 25.10.2007, është tërhequr shuma 2.000.000 lekë dhe është rivendosur përsëri në bono thesari shuma 2.500.000 lekë; më datë 26.10.2007, është tërhequr cash shuma 500.000 lekë; më datë 16.10.2008, pas maturimit, në llogarinë e pagës është transferuar shuma 2.489.304 lekë; më datë 05.12.2008, është tërhequr cash shuma 2.495.000 lekë.

³³Nga verifikimi i të dhënave bankare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar interesat e përfutur nga investimi në bono thesari.

³⁴Idem.

Bank. Shkresa në anën e majtë mban një shënim të nënshkruar nga një person i paidentifikuar, në datën 07.05.2012 [sipas shënimit].

Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, rezulton se në datën 08.02.2013, shuma prej 33.000 eurosh ka kaluar si fond investiminë Raiffeisen Invest. Në datën 30.07.2014, nga llogaria e mësipërme e bashkëshortes së subjektit në Raiffeisen Bank është depozituar shuma 5.000 euro [blerje kuotash] në Raiffeisen Invest.

52.7. Në deklaratat e interesave privatë vjetorë në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurime nga vëllai i tij, D.M., përkatësisht në vlerat 550 euro, 1.850 euro, 3.200 euro dhe 2.200 euro.

52.8. Në deklaratën e interesave privatëvjetorë të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Porositur apartament më datë 14.04.2015, me kontratën nr. {***} rep; nr. {***} kol; me adresë rr. "{***}", nr.{***}, Tiranë. Paguar shuma 50.000 euro për vitin 2015, detyrimi i mbetur 40.000 euro. Vlera 90.000 euro. Burimi i krijimit: Mbyllja e fondit të investimit në "RFZ Invest" në vlerën 37.400 euro dhe pakësimi i gjendjes cash nga kursimet deri në vitin 2014, në vlerën 12.600 euro.* Subjekti ka deklaruar gjithashtu dhurime nga vëllai i tij, D.M., në cash dhe me transfertë monetare, në total 3.500 euro.

52.9. Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Raiffeisen Invest³⁵, rezulton se më datë 30.03.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka shitur kuotat e saj të investuara në këtë fond, në vlerën 37.415 euro. Kjo shumë, referuar të dhënave të përcjella në Komision nga First Investment Bank³⁶, rezulton të jetë transferuar më datë 01.04.2015, në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në këtë bankë.

Më pas, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer tërheqjet si më poshtë.

Më datë 03.04.2015, është tërhequr shuma 20.000 euro.

Më datë 07.04.2015, është tërhequr shuma 7.000 euro.

Më datë 08.04.2015, është tërhequr shuma 7.000 euro.

Më datë 10.04.2015, është tërhequr shuma 3.360 euro.

Nga pasqyrimi i veprimeve të mësipërme, rezulton se deri më datë 07.04.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria bankare në First Investment Bank, shumën prej 27.000 eurosh.

52.10. Gjatë hetimit administrativ në Komision³⁷, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pagesa prej 50.000 eurosh për këstin e parë të pasurisë "apartament", është kryer më datë 07.04.2015 dhe ka paraqitur si provë mandatarkëtimin nr. {***}, datë 07.04.2015, arkëtuar shuma 50.000 euro nga Anton Martini, me përshkrim "Për blerje apartamenti [...]" dhe marrë në dorëzim nga përfaqësuesit e shoqërisë sipërmarrëse "{***}" ShPK. Mandati mban nënshkrimet e dorëzuesit dhe marrësve, si dhe vulën e shoqërisë sipërmarrëse.

53. Nga përshkrimi i fakteve si më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, këstin e parë për pagesën e pasurisë "apartament", e ka kryer më datë 07.04.2015, në vlerën 50.000 euro. Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, vlera prej 50.000 eurosh përbëhet nga kursimet cash nga pagat e tij e të bashkëshortes dhe mbyllja e fondit të investimeve, i cili buronte nga investimi i të ardhurave të përfituara nga kredia e marrë në janar të vitit 2007, me qëllim blerje apartamenti. Deri në datën e

³⁵Informacion i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Invest, me shkresën nr. {***}prot., datë 29.01.2019.

³⁶Informacion i përcjellë në Komision nga First Investment Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.05.2018.

³⁷Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të dërguara në Komision më datë 09.02.2019.

kryerjes së pagesës 07.04.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e saj bankare në First Investment Bank, shumën prej 27.000 eurosh, nga totali prej 37.415 eurosh, shumë e cila ka rrjedhur nga shitja e kuotave në fondin e investimeve në Raiffeisen Invest. Fondi i investimeve në Raiffeisen Invest është krijuar në vitin 2013, si rezultat i investimit të vlerës prej 37.000 eurosh, e cila buronte nga tri depozitime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në vlerat 5.000 euro e 28.000 euro gjatë vitit 2013 dhe 5.000 euro në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se këto shuma buronin nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank në vlerën 5.000.000 lekë, në janar të vitit 2007, të cilat ai i ka pasur gjendje *cash* në banesë, pas tërheqjes nga investimi si bono thesari.

Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave në vitet 2007-2012³⁸, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar investimin e të ardhurave nga kredia në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë në vitet 2007 dhe 2008, por nuk ka deklaruar asnjëherë tërheqjen e tyre dhe disponimin si gjendje *cash* në banesë.

54. Në analizë të sa më sipër, sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ndër vite ka deklaruar vetëm shtesat e pasurisë të krijuara në vitin përkatës dhe jo totalitetin e parave *cash* në banesë dhe në vitin 2007 ka deklaruar shumën e depozituar nga bashkëshortja në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, duke presupozuar se gjysma tjetër ka qenë *cash* në shtëpi, trupi gjykues çmon të marrë në analizë legjislacionin në fuqi të kohës, lidhur me deklarinin e pasurive dhe interesave privatë.

Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003³⁹, zyrtarët deklarues detyrohen të deklarojnë, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë:

[...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; [...].

Sipas kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të pasqyruar çdo ndryshim të interesave privatë në çdo deklarinin periodik. Formulari i deklarinimit të pasurisë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, përshkruan më tej mënyrën se si duhen deklaruar këto ndryshime, duke detyruar subjektet e deklarinimit të deklarojnë në mënyrë të qartë çdo shtesë apo pakësim, që përbën ndryshim të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. Legjislacioni i sipërcituar përcakton detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash* dhe jo të nënkuptohet ekzistenca e tyre si diferencë e veprimeve financiare që mund të jenë kryer, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, pjesa e mbetur e kredisë në vlerën 2.500.000 lekë, pas tërheqjes së saj nga llogaria bankare dhe investimit të gjysmës së saj [2.500.000 lekë] në bono thesari nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2007, përbënte një shtim të gjendjes *cash* në banesë për subjektin e rivlerësimit në fund të vitit 2007 dhe, si e tillë, duhej të deklarohet në deklaratën e interesave privatë të këtij viti. Po kështu edhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte shtimin e gjendjes *cash* në banesë, në vlerën 2.500.000 lekë, për shkak të tërheqjes së investimit në bono thesari të të ardhurave nga kredia. Mosdeklarimi i vlerave të mësipërme në deklarinimet e interesave privatë, si shtesa të likuiditeteve *cash* në banesë, në fund të viteve 2007 dhe 2008, e më tej në asnjë prej viteve në vijim, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, krijon bindjen se këto shuma nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për investimet në fondin e investimeve në Raiffeisen Invest në vitet 2013 e 2014, tërheqja e të cilave në vitin 2015 është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për

³⁸Verifikim i kryer për këtë periudhë, pasi kredia është disbursuar më datë 09.01.2007 dhe investimi i parë në fondin e investimit në Raiffeisen Invest është kryer më datë 08.02.2013, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

³⁹Sipas përcaktimeve që ky ligj kishte në periudhën 2007-2012, periudha objekt verifikimi në të cilën janë bërë deklarinimet prej subjektit të rivlerësimit.

pagesën e kështit të parë për blerjen pasurisë “apartament” në po të njëjtin vit, edhe për faktin se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, rreth 7 vjet, nga marrja e kredisë e disponimi i pretenduar i saj në vlerë *cash* në banesë, deri në investimin e saj në bono thesari.

55. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se fakti që këto dy shuma prej 2.500.000 lekësh kanë qenë gjendje *cash* në shtëpi, është provuar edhe me deklarin shtetë qe ai ka bërë pranë ILDKPKI-së më datë 03.05.2012, me dokumentin e emërtuar “Shtesë për deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2011”, çmohet nga trupi gjykues pa efekt në drejtim të provimit të këtij pretendimi, pasi:

Së pari, kjo deklaratë nuk krijon besueshmërinë te trupi gjykues se është administruar në kuadër të kryerjes së një procesi verifikimi paraprak nga ILDKPKI-ja në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003⁴⁰, pasi nuk përmban asnjë nga elementet e duhura të administrimit, numër protokoll apo vulën e institucionit pranues të deklaratës, si dhe nuk ka asnjë praktikë bashkëlidhur që të vërtetojë inicimin dhe përfundimin e një procesi të tillë.

Së dyti, në vijim të analizës së mësipërme ligjore, kjo deklaratë, edhe sikur të ishte në formën e duhur, “korrigjon” deklarin e vitit 2011 dhe jo atë të viteve 2007- 2010, në të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar posedimin e të ardhurave nga kredia në gjendje *cash* në banesë, duke mos arritur kështu të provojë se burimi i depozitimit të vlerës prej 33.000 eurosh në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, në vitin 2010 në vlerën 5.000 euro dhe në vitin 2011 në vlerën 28.000 euro, buron nga të ardhurat nga kredia e marrë në vitin 2007. Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti se shuma prej 5.000 eurosh e depozituar nga bashkëshortja e subjektit në datën 16.04.2010, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se ka rrjedhur nga të ardhurat nga kredia⁴¹, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010 është deklaruar prej tij si kursim nga rroga vjetore e tij dhe e bashkëshortes në vlerën 700.000 lekë, të cilat më pas i ka konvertuar në vlerën 5.000 euro dhe i ka depozituar në emrin e bashkëshortes në Bankën Raiffeisen. Pra, vetë subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave të vitit 2010 ka deklaruar se vlera prej 5.000 eurosh nuk buron nga kredia, por nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes.

Në depozitimin e pjesës tjetër prej 28.000 eurosh, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në përshkrimin e veprimit bankar “derdhje nga kredia”, por ky deklarim nuk u konsiderua relevant nga trupi gjykues, pasi është një vetëdeklarim i kryer në funksion të një veprimi rutinë bankar, që nuk mund të zhbëjë deklarimet e bëra prej subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave privatë, për të cilat ligji nr. 9049/2003 parashikon detyrimin e plotësimit me saktësi e vërtetësi, pasi në të kundërt subjekti deklarues mban përgjegjësi ligjore.

Për pasojë, deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklarimet periodike të interesave është mbizotërues, edhe në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili ka parashikuar në mënyrë të posaçme vlerën provuese të deklaratave periodike të interesave.

56. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik se shuma prej 37.400 eurosh që rrjedh nga depozitimet në Raiffeisen Invest në vitet 2010-2011, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur me burim fillestar kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2007, nuk justifikohet me burime të ligjshme.

⁴⁰Ligji nr. 9049/2003, në nenin 24, “Përpunimi paraprak”, parashikon:

“Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës dhe të anekseve, dokumentet justifikuese dhe ligjshmërinë e tyre.

Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato”.

⁴¹Shuma prej 33.000 eurosh, e depozituar në Raiffeisen Bank nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, është realizuar nëpërmjet dy derdhjeve: shuma prej 5.000 eurosh është derdhur në datën 16.04.2010, ndërsa në datën 28.07.2011 është derdhur në po në të njëjtën llogari, shuma 28.000 euro.

Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, se kredia e marrë në janar të vitit 2007 ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë “apartament”, nuk i përgjigjet së vërtetës, duke plotësuar në këtë mënyrë situatën e cila duhet kualifikuar si deklarim i pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

57. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik, lidhur me mungesën e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të mbuluar pagesën e këstit të parë në vlerën 50.000 euro, për pasurinë “apartament”, trupi gjykues, në dritën edhe të përfundimeve të arritura nga analiza e mësipërme mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit të kësaj vlere, konstaton si më poshtë.

57.1. Pagesa e këstit të parë për pasurinë “apartament” është kryer nga subjekti i rivlerësimit më datë 07.04.2015, në vlerën 50.000 euro, siç ka rezultuar nga të dhënat e mandatarkëtimit të administruar si provë gjatë hetimit administrativ në Komision dhe siç është pranuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj⁴².

57.2. Deri në datën e kryerjes së pagesës, 07.04.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e saj bankare në First Investment Bank, shumën prej 27.000 eurosh, nga totali prej 37.415 eurosh, që ka rrjedhur nga depozitimet në Raiffeisen Invest në vitet 2010-2011, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur me burim fillestar kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2007, shumë e cila në analizën dhe vlerësimin e trupit gjykues në paragrafët më sipër në këtë vendim⁴³, nuk justifikohet me burime të ligjshme.

58. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi t’ia nënshtrojë analizës financiare kryerjen e pagesës së këstit të parë për pasurinë “apartament” në vlerën 50.000 euro, për të vlerësuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar këtë shumë me burime të ligjshme, nga data 01.01.2003 deri në datën 07.04.2015, datë në të cilën është provuar kryerja e pagesës.

Trupi gjykues, në këtë vlerësim nuk ka konsideruar në përlllogaritje shumën prej 27.000 eurosh, e cila, siç u arsyetua më sipër në këtë vendim, nuk është krijuar me burime të ligjshme, duke e konsideruar vlerën prej 50.000 eurosh si të realizuar nga kursimet e subjektit të rivlerësimit në vite, nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes së tij.

59. Kursimet në formën e likuiditeteve *cash* në banesë, shtesat dhe pakësimet e tyre, u konsideruan nga trupi gjykues, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në deklaratat periodike të interesave, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga shqyrtimi i hollësishëm i deklaratave periodike të interesave në vite, trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me likuiditetet *cash* në banesë, ka qenë:

- Në deklaratën e interesave të vitit 2003: *Të holla në cash, vlera 0,250 milion lekë. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e grumbulluara nga të ardhurat mujore.*
- Në deklaratën e interesave të vitit 2004: *Gjendje në cash, vlera 450.000 lekë.* [Nuk ka deklaruar burim krijimi.]
- Në deklaratën e interesave të vitit 2005: *Shtesë në para në gjendje cash, vlera 600.000 lekë.* [Nuk ka deklaruar burim krijimi.]
- Në deklaratën e interesave të vitit 2006: *Kam në shtëpi gjendje cash 450.000 lekë.* [Nuk ka deklaruar burim krijimi.]
- Në deklaratën e interesave të vitit 2007: *Kursime nga paga dhe shpërblime nga puna si prokuror (para në cash), vlera 500.000 lekë.*

⁴²Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 30.03.2021.

⁴³Paragrafi 54, më sipër në këtë vendim.

- Në deklaratën e interesave të vitit 2008: *Kursime nga paga dhe shpërblime nga puna si prokuror (para në cash), vlera 400.000 lekë.*
- Në deklaratën e interesave të vitit 2009: *Para cash nga rroga ime dhe e bashkëshortes për vitin 2009, vlera 500.000 lekë.*
- Në deklaratën e interesave të vitit 2010: nuk ka deklarime mbi likuiditetet *cash* në banesë.
- Në deklaratën e interesave të vitit 2011: *Kursime nga paga ime dhe bashkëshortes (si në llogaritë bankare dhe cash) deri më 31.12.2011, vlera 500.000 lekë.*
- Në deklaratën e interesave të vitit 2012: *Kursime nga paga ime dhe bashkëshortes në vitin 2012, vlera 410.000 lekë.*
- Në deklaratën e interesave të vitit 2013: *Kursime nga paga ime dhe bashkëshortes në vitin 2013, vlera 420.000 lekë.*
- Në deklaratën e interesave të vitit 2014: *Kursime nga paga ime dhe bashkëshortes në vitin 2014, vlera 400.000 lekë.*

Nga verifikimi i arsyetimit të Komisionit në vendim⁴⁴, trupi gjykues konstaton se Komisioni, çdo deklaram të subjektit të rivlerësimit në vite si më sipër, e ka konsideruar si shtesa të likuiditeteve *cash* duke pranuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ e duke arritur për pasojë në përfundimin se në fund të vitit 2014, vlera totale e parave *cash* në banesë, të disponuara nga subjekti i rivlerësimit, është në shumën 4.661.720 lekë.

60. Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, çmon se do të konsiderohen me vlerë provuese në kuptim të këtij procesi, deklaramet e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaramat periodike të interesave, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.*

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaramet e likuiditeteve *cash* në banesë, nuk ka ndjekur një logjikë konstante deklarimi, duke deklaruar herë “gjendjen” e herë “shtesat” e tyre në vitin përkatës. Nga viti 2003 deri në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e parave *cash* në banesë në fund të çdo viti dhe jo shtesat e tyre. Likuiditetet *cash* shtesë në fund të çdo viti janë deklaruar nga viti 2007 deri në vitin 2014. Si rezultat, trupi gjykues vlerëson se likuiditetet *cash* në banesë në vitin 2004 janë shtuar me 200.000 lekë, në vitin 2005 shtuar me 150.000 lekë, në vitin 2006 pakësuar me 150.000 lekë e në vitet në vazhdim, janë shtuar sipas deklarameve të subjektit të rivlerësimit në deklaramat përkatëse të interesave privatë. Trupi gjykues vlerësoi të përfshijë këto vlera në analizën financiare për periudhën 01.01.2003-07.04.2015.

Në këtë analizë, trupi gjykues konsideroi dhe shumat e dhuruara subjektit të rivlerësimit nga të afërmit e tij, sipas arsyetimit në vijim të këtij vendimi⁴⁵.

Në vlerësim të panoramës së situatës financiare, referuar analizës financiare të kryer si më lart, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar pagesën e këstit të parë prej 50.000 eurosh, në datën 07.04.2015, për blerjen e pasurisë “apartment”, në shumën 6.744.035 lekë. Për pasojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet përpara parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

61. Në analizë të gjithë sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se shkaku i ankimit të Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së këstit të parë të pasurisë “apartment”, është i drejtë dhe vendimi i Komisionit për këtë pjesë është i cënueshëm.

⁴⁴Paragrafët 29.35 - 29.38 të vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit.

⁴⁵Sipas vlerësimit të trupit gjykues në paragrafin 67, në vijim, në këtë vendim.

62. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive, kursimeve në cash apo kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 2003-2016, si dhe krijimin e kursimeve cash në vlerën e dekluarar në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit*, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
63. Komisioneri Publik ka pretenduar në ankimin e tij, se lidhur me kursimet *cash* të krijuara gjatë periudhës 2003-2016, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore të interesave dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë e të pamjaftueshëm, pasi, treguesit e analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me gjendjen e parave *cash*/kursimet ndër vite, duhet të bazoheshin vetëm mbi sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike, si për shumat e deklaruara të kursyera edhe për burimin e deklaruar të tyre, dhe jo mbi sa ai ka shpjeguar gjatë shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, zëri kursime në *cash* duhej llogaritur sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave, si për shumën e deklaruar të kursyer, ashtu dhe për burimin e deklaruar. Sipas ankimit të Komisionerit Publik, Komisioni nuk duhej të kishte përfshirë në analizën financiare të ardhurat e deklaruara të dhuruara nga vëllai i subjektit, z. D.M., në periudhën 2011-2014, përse kohë që rezulton se të ardhurat e dokumentuara nga personi tjetër i lidhur nuk janë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës në Britaninë e Madhe dhe dhurimet e bëra. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 2003-2016. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, në shqyrtim të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, Komisioneri Publik parashtroi⁴⁶ se përse u përket të ardhurave të dhuruara nga vëllezërit, subjekti i rivlerësimit paraqiti akte dhe provoi mundësinë financiare të vëllait të tij, z. D.M., për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e dhuruara subjektit, të deklaruara në deklaratat periodike të interesave. Gjithsesi, Komisioneri Publik vlerësoi se ky konkluzion nuk ndikon në vlerësimin tërësor të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e burimeve për krijimin e pasurive.
64. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në kundërshtim të pretendimeve të Komisionerit Publik, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtroi se për shkak të marrëdhënieve të mira familjare, vëllezërit e tij, që punojnë e jetojnë prej vitesh jashtë Shqipërisë, përkatësisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe ShBA, i kanë dërguar atij dhe bashkëshortes sasi të ndryshme parash nëpërmjet agjencive të transfertave monetare “Money Gram” dhe “Western Union”, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në deklaratat periodike të interesave. Diferenca nga të ardhurat e deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për transfertat monetare nga vëllezërit e tij, me të dhënat e përcjella nga këto agjenci në Komision, vjen nga fakti se këto agjenci mbajnë të regjistruara të dhënat vetëm për pesë vitet e fundit. Komisioni e ka bërë kërkimin në vitin 2019 dhe, për rrjedhojë, informacioni i dërguar nga këto agjenci referon mbi veprimet e kryera në periudhën 2014-2019, ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka kryer kërkimin pranë këtyre agjencive në vitin 2017, për pasojë informacioni i marrë prej tij referon në periudhën 2012-2017. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ai, nga viti 2011 e në vijim, në mënyrë korrekte, ka deklaruar në deklaratat periodike të interesave çdo vlerë *cash* që vëllai D.M. i ka dhuar gjatë vizitave në Shqipëri. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka marrë dhe çdo dokument tjetër për të ardhura të tjera dhe e ka bashkëlidhur, ndërsa të ardhurat *cash* ishin deklaruar me korrektesë në deklaratimet e mëparshme. Për këtë shkak, subjekti i rivlerësimit ka

⁴⁶Në parashtrimet përfundimtare të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 01.06.2021.

kërkuar që dhuratat në vlera monetare *cash* nga vëllai i tij, të vlerësohen së bashku me të ardhurat e tjera të deklaruara prej tij në vite. Subjekti i rivlerësimit parashtroi gjithashtu se dokumentacioni i marrë në formën e kërkuar nga ligji, i paraqitur prej tij dhe i administruar si provë në Kolegj, provon se bashkëshortja e vëllait të subjektit të rivlerësimit, znj. E. M., ka pasur të ardhura të ligjshme e të mjaftueshme për të justifikuar dhurimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave.

65. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues, në vijim të pasqyrimin të situatës faktike në paragrafin 59 më sipër në këtë vendim, konstaton si vijon.

65.1. Në deklaratën e interesave privatë vjetorë të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtesë në cash gjatë vitit 2015, vlera 400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat e vitit 2015.*

65.2. Në deklaratën e interesave privatëvjetorë të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime nga paga ime dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2016, vlera 250.000 lekë, si dhe: Dhuratë (veprim i kryer në muajin korrik 2016) nga D.M., i cili është vëllai im, vlera 3.200 euro.* Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, ndërmjet shpenzimeve të tjera, ka deklaruar dhe “Shpenzime për arredimin e banesës” në vlerën 2.000.000 lekë.

65.3. Nga të dhënat e përcjella në Komision nga agjencitë e transfertave monetare⁴⁷, si dhe nga të dhënat që këto agjenci i kanë përcjellë subjektit të rivlerësimit⁴⁸, rezulton se bashkëshortja e tij ka qenë përfituese e transfertave monetare të dërguara nga z. D.M. dhe znj. E. M., nëpërmjet shërbimeve “Money Gram” dhe “Western Union”, në periudhën 2012-2016, në shumën 1.105.563 lekë.

65.4. Nga të dhënat e përcjella në Komision nga Raiffeisen Bank, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, dhe znj. H. M., në cilësinë e bashkëkredimarrësit, kanë lidhur me Raiffeisen Bank, në cilësinë e kredidhënësit, kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2016, me objekt kredidhënie konsumatore me hipotekë, në vlerën 5.200.000 lekë, me afat 15 vjet.

Kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 07.10.2016 dhe në të njëjtën datë bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e ka tërhequr atë.

66. Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave, trupi gjykues konstaton se vlera e dhurimeve nga vëllai, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është në vlerën totale 2.004.817 lekë, pra më e madhe sesa vlera e transferuar nëpërmjet agjencive monetare. Trupi gjykues vlerësoi të pranojë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, se kjo diferencë ka ardhur për shkak se një pjesë e dhurimeve është kryer *cash* nga vëllai i tij gjatë vizitave në Shqipëri, ose nëpërmjet dërgesave të parave *cash* me të tretë. Për këtë arsye, në analizën financiare të kryer për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të

⁴⁷Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.01.2019, institucioni financiar “AK Invest” ka përcjellë në Komision informacionin për transaksionet e kryera në favor të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet shërbimit “Money Gram”. Me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2019, institucioni financiar “Unioni financiar Tiranë” ka përcjellë informacionin për transaksionet e kryera në favor të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, znj. H. M., nëpërmjet shërbimit “Western Union”.

⁴⁸Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.01.2017, institucioni financiar “AK Invest” i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit informacionin për transaksionet e kryera në favor të tij dhe të bashkëshortes së tij, nëpërmjet shërbimit “Money Gram”.

subjektit të rivlerësimit, për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, kursimeve në *cash* apo kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 2003-2016, trupi gjykues konsideroi vlerat e deklaruara si dhurime në deklaratat periodike të interesave në vitet përkatëse dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

67. Nga vlerësimi i kryer nga trupi gjykues, për të analizuar faktin nëse personat e tjerë të lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit D.M. dhe bashkëshortja e tij E. M., justifikonin me burime të ligjshme shumën e dhuruar subjektit të rivlerësimit, u konsideruan të ardhurat e ligjshme të këtyre personave në raport me shpenzimet e konsumuara për jetesë, nga ku rezultoi se ata justifikonin me burime të ligjshme dhurimet e kryera, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues u mbështet në aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në provat e paraqitura e të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, në lidhje me të ardhurat e ligjshme dhe pagesat e taksave nga D. e E. M. në Mbretërinë e Bashkuar, ku ata jetojnë e punojnë.
68. Në vijim të analizës financiare të kryer për periudhën 01.01.2003-07.04.2015, trupi gjykues kreu vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, kursimeve në *cash* apo kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 08.04.2015-31.12.2016, me të njëjtën metodologji. Në këtë analizë, trupi gjykues nuk ka përllogaritur shumat e tërhequra nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit më datë 08.04.2015, në vlerën 7.000 euro dhe më datë 10.04.2015, në vlerën 3.360 euro, nga fondi i investimeve në Raiffeisen Invest, në vijim të vlerësimit të bërë në paragrafët 54-56 më sipër në këtë vendim, sipas të cilit shuma e investuar në këtë fond nuk është krijuar me burime të ligjshme.
69. Në përfundim të analizës financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 08.04.2015-31.12.2016, nuk kishte burime të mjaftueshme financiare në shumën 24.181 lekë për të përballuar shpenzimet e krijimin e kursimeve të tij. Ndërsa, referuar situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për të gjithë periudhën 01.01.2003-31.12.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme krijimin e pasurive, kursimeve në *cash* dhe shpenzimeve të kryera në këtë periudhë, në shumën 6.099.092 lekë.
- Trupi gjykues çmon të theksojë se edhe nëse analiza financiare do të kryhej në një qëndrim tejet garantist, duke pranuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vlera prej 37.000 eurosh, e tërhequr nga Fondi i Investimeve në Raiffeisen Invest në vitin 2015 buron nga investimi i shumës së kredisë së marrë në janar të vitit 2007 që ai e dispononte *cash* në banesë⁴⁹, rezulton përsëri se ai ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, kursimeve në *cash* dhe shpenzimeve të kryera në vlerën 3.042.694 lekë.
70. Përsa u përket kursimeve në *cash*, në vlerën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues vëren se vlerësimi i mundësisë së subjektit të rivlerësimit për financimin e tyre me burime të ligjshme, varet detyrimisht nga rezultati i analizës financiare për periudhën 2003-2016, bazuar në deklarin e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 800.000 lekësh ka buruar nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga puna ndër vite⁵⁰. Referuar analizës financiare për periudhën 2003-2016, si rezultat i së cilës subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të krijuar kursimet në *cash*, trupi gjykues vlerëson se kjo mungesë burimesh, logjikisht reflektohet edhe në mundësinë e krijimit të kursimeve në *cash* në

⁴⁹ Shih pretendimin e subjektit të rivlerësimit, të pasqyruar në paragrafët 51 dhe 64 më sipër në këtë vendim.

⁵⁰ Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në faqen 8, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shuma prej 800.000 lekësh në formë *cash* jashtë sistemit bankar, për nevoja të familjes. Burimi i krijimit janë të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga puna jonë ndër vite”.

vlerën 800.000 lekë, të deklaruara si gjendje në banesë, më datë 26.01.2017. Pavarësisht kësaj rrjedhoje logjike, trupi gjykues, në kuadër të një vlerësimi objektiv, verifikoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit, për të krijuar kursimet në *cash* të deklaruara, për periudhën 01.01.2017-26.01.2017, nga ku rezultoi një diferencë negative prej 579.716 lekësh.

71. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë të tij, kursimeve dhe përballimin e shpenzimeve për periudhën 2003-2016, si dhe për kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të Komisionerit Publik gjendet i bazuar.

Ç. Vlerësimi i trupit gjykues për vlerësimin e aftësive profesionale dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

72. Komisioneri Publik ka kundërshtuar vendimin e Komisionit nr. 231, datë 29.01.2020, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar në ankim se vlerësimi i Komisionit për këtë kriter është i cenueshëm, pasi bazohet në një vlerësim jo të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm. Sipas Komisionerit Publik, mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit të evidentuara nga raporti i GPPP-së dhe nga hetimi i kryer nga Komisioni janë të dukshme, dhe të tilla sa, së bashku me vlerësimin tërësor të çështjes, çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga ai i konkluduar nga Komisioni në vendim për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e aplikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
73. Në lidhje me shkakun e ankimit të parashtruar nga Komisioneri Publik, sipas të cilit *për ankesën e gazetarit A.Xh., drejtuar me e-mail Prokurorit të Përgjithshëm, protokolluar me nr. {***}, datë 06.01.2014 dhe nr. {***}, datë 06.01.2014, nga Zyra e Sektorit Publik, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, nuk ka mbledhur provat e nevojshme të kërkuara me ligj, nuk ka treguar aftësinë për të marrë në pyetje, mosveprime të cilat kanë çuar në shmangien nga dënimi më i rëndë i autorëve të kryerjes së veprës penale në disa episode, kanë sjellë pasoja të rënda për shtetas të tjerë, të cilat eventualisht mund të ishin shmangur në rast të hetimit të plotë të kallëzimit të depozituar nga shtetasi A.Xh., trupi gjykues konstaton se në vendim, në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni nuk e ka trajtuar këtë ankesë, duke mos i dhënë rëndësi në vlerësimin përfundimtar të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, megjithëse ajo ka qenë e analizuar në raportin e GPPP-së dhe gjetje e rezultateve të hetimit administrativ të vetë Komisionit.*
74. Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se në raportin e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Anton Martini, me nr. {***}prot., datë 07.06.2018, të GPPP-së, në rubrikën “Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme”, është trajtuar ankesa e gazetarit A.Xh., drejtuar *online* Prokurorit të Përgjithshëm. Lidhur me këtë ankesë, referuar raportit⁵¹, rezulton se shtetasi A.Xh., me profesion gazetar, më datë 30.12.2013, ka drejtuar nëpërmjet postës elektronike, një ankesë në adresën e posaçme të *e-mail*-it të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila është regjistruar me nr.

⁵¹ Ankesa është trajtuar në faqet 54-55 të raportit të GPPP-së.

{***} prot., datë 06.01.2014, nga Zyra e Sektorit Publik të këtij institucioni. Në verifikim të ankesës së këtij shtetasi⁵², Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion lidhur me ecurinë e hetimeve të këtij procedimi penal. Me shkresën nr. {***}, datë 17.01.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka dërguar informacionin e prokurorit Anton Martini “Mbi hetimet e procedimit penal nr.{***}, të vitit 2013”. Mbi bazën e këtij informacioni, prokurori i ngarkuar me ndjekjen e ankesës, ka informuar eprorin e tij lidhur me ecurinë e hetimit të procedimit, duke sqaruar se janë duke u kryer veprimet e nevojshme për sqarimin e rrethanave të faktit të kallëzuar. Në vijim, është vlerësuar se kallëzuesi është larguar jashtë territorit të vendit dhe ka dyshime se po e përdor kallëzimin si shkak për të përfutur azil në një shtet të BE-së. Në këto rrethana, duke mos pasur një adresë, i është lënë porosi Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun t’i kthehet përgjigje ankuesit në adresën e e-mail-it, se: *procedimi është në fazën e hetimeve paraprake dhe në përfundim të hetimeve do të vihet në dijeni me zgjidhjen përfundimtare nga Prokuroria për Krimet e Rënda.*

75. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë ankesë⁵³. Në shpjegimet e tij, në lidhje me gjetjet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:*Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, kallëzimi i shtetasit A.Xh. është regjistruar me nr. {***} prot., datë 10.07.2013. Po në këtë datë, nga drejtuesi i Prokurorisë më është caktuar të trajtoj materialin. Po në këtë datë kam regjistruar procedimin penal nr. {***} të vitit 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1-25 të Kodit Penal. [...] Më datë 11.07.2013, kam përpiluar urdhër delegimi, duke ngarkuar me veprime konkrete oficerët e policisë gjyqësore, të cilët brenda 20 ditësh duhet të kryenin verifikime për identifikimin e shtetasve të dyshuar E. dhe K., [...] pyetjen e kallëzuesit A.Xh. si deklarues për ngjarjen etj. Më datë 11.07.2013, kam kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë autorizimin e përgjimit të numrave celularë si të atyre të identifikuar që përdorëshin nga shtetasit E. dhe K., po ashtu edhe të kallëzuesit A.Xh. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendim nr. {***}, datë 11.07.2013, ka autorizuar përgjimin e numrave celularë për një periudhë prej 15 ditësh. Mbi kërkesën tonë, me vendimin nr. {***}, datë 26.07.2013, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë ka zgatur autorizimin edhe për një periudhë tjetër prej 40 ditësh. Po më datë 11.07.2013, kemi dërguar shkresa në kompanitë celulare që operojnë në Shqipëri, me qëllim përfitim të identitetit të personave që kanë të regjistruar numrat celularë të cituar nga kallëzuesi [...]. Mbi informacionin e oficerit të Policisë Gjyqësore, të ardhur në Prokurorinë për Krime të Rënda më datë 18.07.2013 [...], ku identifikoheshin emrat e shtetasve E. M. dhe K. D., unë po në këtë datë kam urdhëruar thirrjen e tyre për t’i pyetur në lidhje me çështjen në fjalë. [...] Në datë 18.07.2013⁵⁴ u urdhërua dhe thirrja e kallëzuesit A.Xh., por ai nuk u paraqit asnjëherë, pasi në datë 22.07.2013 largohet nga Shqipëria në drejtim të një vendi të BE-së, ku*

⁵² Në mënyrë të përmbledhur, shtetasi A. Xh. ankohet se në korrik 2012 ka rënë pre e një skeme mashtrimi, e cila shkoi deri në pengmarrje me armë dhe, për pasojë, ai ka denoncuar ngjarjen në Drejtorinë e Policisë së Tiranës. Në prokurori, çështjen e kishte prokuror Anton Martini. Personat e akuzuar nuk u morën në pyetje nga prokurori dhe iu dha gjithë koha e nevojshme për të ngritur alibi të rreme. Në kushtet e të ndierit i rrezikuar, ankuesi është larguar nga Shqipëria. Për çdo kërcënim të bërë ndaj tij, ai ka vënë në dijeni prokurorin, por ky i fundit nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim. Ankuesi kërkon informacion se çfarë është bërë me çështjen e tij.

⁵³ Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon. “Komisioni administroi dosjen e plotë të këtij procedimi penal, ku nga verifikimi i kryer lidhur me këtë dosje duket se: (i) ka vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore; (ii) janë të vakëta përpjekjet tuaja për të thërritur dhe pyetur të dyshuarin kryesor në fazën e hetimeve paraprake; (iii) ankuesi (pala e dëmtuar) ka referuar disa përpjekje për të marrë dijeni për ecurinë e hetimeve; (iv) nuk është njoftuar i dëmtuari (z. Xh.) për zgjatjen e afateve hetimore; (v) vendimi i gjykatës referon mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana juaj, për këtë rast”.

⁵⁴ Subjekti në shpjegimet e tij ka referuar një datë të gabuar, pasi sipas akteve në fashikull, urdhër-thirrja për individin Xh. është e datës 18.10.2013.

dhe kërkoi azil. [...] Janë bërë disa përpjekje për njoftim, me qëllim pyetjen e tij si deklarues, por kallëzuesi nuk është gjendur, pasi ishte larguar jashtë shtetit. Pikërisht mosardhja e tij për të deklaruar ka qenë arsyeja e vendimit të gjykatës, e cila e konsideroi të pamundur deklarimin fajtor të të akuzuarve për sa kohë nuk kishim një deklaram të tij. Më datë 26.07.2013, shtetasve E. M. dhe K. D. iu regjistrohët emri si persona nën hetim, mbi dyshimet se kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1-25 të Kodit Penal. Më datë 26.07.2013 dhe 29.07.2013, shtetasja K. D. pyetet me këtë cilësi nga ana ime duke u mbajtur procesverbalet përkatëse. [...] Pasi bashkuam procedimin penal nr. {***/2013 me atë me nr. {***/2014, më datë 08.09.2014 vendosëm për interesa hetimi, vijimin e kryerjes së veprimeve të tjera hetimore për sigurimin e provave. [...] Gjatë kësaj kohe kam qenë shumë aktiv në hetime, duke kryer vetë disa prej veprimeve hetimore. Kam përpiluar 4 urdhra delegimi për oficerët e policisë gjyqësore, që fillojnë nga data 11.07.2013 e në vijim, për të dy procedimet, si dhe kur ato u bashkuan. Mbi kërkesën tonë të datës 13.09.2014, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë vendosi masat e sigurimit “arrest me burg” në mungesë për shtetasit E. M. dhe K. D.. [...] më datë 29.12.2014 aktet kaluan për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë. Në konkluzionet përfundimtare të datës 10.03.2015, jam munduar të arsyetoj me të gjitha provat e mbledhura nga hetimi paraprak, përgjegjësinë penale të të akuzuarve E. M. dhe K. D. në raport me kallëzuesin A.Xh. e për këtë kam kërkuar edhe dënimin me burg të tyre. Por, gjykata në arsyetimin e saj, pa deklaramet e dhëna nga ky shtetas, nuk arrin të bindet për fajësinë e të pandehurve në lidhje me këtë episod. [...] Lidhur me mosnjoftimin e të dëmtuarit A.Xh. për zgjatjen e afateve të hetimit, dua të shprehem se ky njoftim ishte i pamundur, sepse ai nuk u paraqit as të pyetjet si deklarues gjatë gjithë hetimit paraprak, edhe pse hetimi u zgjat në pritje të marrjes së deklarameve të tij.

76. Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën, për sa i është kërkuar në rezultatet e hetimit administrativ. Mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit janë të dukshme dhe të tilla që çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga ai i Komisionit për qëllim të procesit të rivlerësimit, pasi nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se subjektit i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer hetim në mënyrë shteruese të rastit dhe ka munguar në marrjen e veprimeve procedurale të nevojshme hetimore për hetimin e plotë të çështjes dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të veprës penale; nuk dokumentohet përpjekja e subjektit për të pyetur shtetasin A.Xh. mbi kallëzimin penal të bërë nga ana e tij, për më tepër në kushtet kur vepra penale kishte një karakter dhe rrezikshmëri të lartë. Sipas Komisionerit Publik, vonesat procedurale të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e hetimeve të rastit konkret kanë vazhduar derisa pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, më shumë se një vit pas kallëzimit të shtetasit A.Xh., është regjistruar procedimi penal që ka si objekt të njëjtën veprë penale dhe si autorë të kallëzuar për kryerjen e veprës penale, të njëjtat subjekte, si në rastin e kallëzimit të shtetasit A.Xh.. Nga aktet në dosje, rezulton se pasojat e veprës penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për marrjen e pasurisë”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b/1-25 i Kodit Penal, kanë qenë të një rrezikshmërie më të lartë në rastin e shtetasit A.Xh., duke shkaktuar pasoja më të rënda pasurore dhe sociale për personat e përfshirë. Komisioneri Publik çmon se rezultatet e hetimit administrativ në këtë rast duhet të vlerësohen sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”). Rrethanat e dala nga vlerësimi i këtij rasti, në vështrim dhe të vlerësimit tërësor të çështjes, sipas Komisionerit Publik kanë elemente të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

77. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultat e hetimit administrativ, duke theksuar se kallëzuesi A.Xh. nuk u pyet asnjëherë në lidhje me ngjarjen, si dhe nuk u njoftua me cilësinë e të dëmtuarit nga vepra penale lidhur me zgjatjen e afateve të hetimit, pasi ishte larguar jashtë vendit, duke mosbashkëpunuar me hetimin pas paraqitjes së kallëzimit. Për të provuar faktin e largimit të z. A.Xh. jashtë vendit, pasi kishte depozituar kallëzimin dhe kthimin e tij vetëm pasi kishte përfunduar gjykimi i çështjes, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. {***} prot., datë 10.12.2020, drejtuar z. Anton Martini, me lëndë: “Konfirmim nga TIMS për hyrje-daljet e shtetasit A.Xh.”, provë e cila u administrua nga trupi gjykues. Nga të dhënat e sistemit TIMS, rezulton se shtetasi A.Xh.ka dalë nga territori shqiptar më datë 21.07.2013 dhe është rikthyer më datë 01.08.2015.
78. Në lidhje me këtë shkak ankimi, në analizë të të dhënave të dosjes hetimore të çështjes penale nr. {***}/2013, e përcjellë në Komision nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë⁵⁵, trupi gjykues konstaton si vijon.
- Shtetasi A.Xh., me profesion gazetar, më datë 07.07.2013, ka bërë kallëzim⁵⁶ pranë Seksionit të Vjedhjeve me Dhunë dhe Armë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe më datë 10.07.2013, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.{***}, lidhur me veprën penale të “Shtrengimit me anë të kanosjes ose dhunës për marrjen e pasurisë”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b/1-25 i Kodit Penal, në bazë të akteve të referuara nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.
- Më datë 16.07.2013, Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka dërguar informacion mbi identifikimin e të pandehurve E. M. dhe K. D., si dhe për numrat celularë në përdorim të tyre. Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, datë 10.07.2013 dhe në vijim, në dosjen penale nuk ka asnjë akt që të dokumentojë përpjekjen e prokurorit të çështjes – subjektit të rivlerësimit – për të marrë deklaratimet e kallëzuesit A.Xh. mbi kallëzimin penal të bërë nga ana e tij. Urdhër-thirrja e subjektit për paraqitjen e z.Xh. me qëllim dhënien e deklaratimeve para oficerit të policisë gjyqësore është nxjerrë në datën 18.10.2013, pra rreth 2 muaj më vonë nga momenti i regjistrimit të procedimit penal. Sipas deklaratimeve në Komision të subjektit të rivlerësimit, por dhe në informacionin që ka dërguar për këtë procedim në Prokurorinë e Përgjithshme, z.A.Xh. në momentin kur është lëshuar urdhër-thirrja për të ishte larguar jashtë vendit, siç rezulton edhe nga të dhënat e sistemit TIMS, të administruara nga trupi gjykues si më sipër në këtë vendim. Edhe pas verifikimit të personave të kallëzuar të veprës penale pas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me marrjen e të dhënave nga persona që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale apo subjekteve të konsideruara nën hetim për kryerjen e veprës penale. Të dhënat e marra nga kompanitë celulare për numrat celularë të shtetasve të kallëzuar dhe kallëzuesit, të cilat konfirmojnë komunikimet e pretenduara nga shtetasi A.Xh. me të kallëzuarit, janë administruar pas disa muajve nga momenti i kallëzimit të bërë nga ky shtetas. Veprime procedurale të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e hetimeve të rastit konkret

⁵⁵Dosja hetimore e çështjes penale nr. {***}/2013, është përcjellë në Komision nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë me shkresën nr. {***} prot., datë 24.09.2019, në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. {***} prot., datë 17.09.2019.

⁵⁶Shtetasi A. Xh., me profesion gazetar, më datë 07.07.2013, ka bërë kallëzim pranë Seksionit të Vjedhjeve me Dhunë dhe Armë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë kundrejt shtetasve të njohur prej tij me emrin “K.” dhe “E.”. Shtetasi A. Xh. kallëzon, në mënyrë të përmbledhur, se pas njohjes dhe disa takimesh me shtetasen K., në takimin e datës 06.07.2013 ata janë “diktuar” nga shtetasi E., i cili i ka marrë të dy në makinë nën kërcënim dhe i ka çuar në fshatin Baldushk dhe duke e kërcënuar A.për takimin që ky ka pasur me bashkëshorten e tij, i kërkuar në formë “gjobe” fillimisht shumë prej 5.000 eurosh e në vijim një sasi më të vogël prej 2.000 eurosh.

evidentohen vetëm pasi pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, më datë 05.09.2014, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë. Kallëzimi i bërë nga z. E. H. në datën 04.09.2014, ka si objekt të njëjtën veprë penale dhe si autorë të kallëzuar për kryerjen e veprës penale, të njëjtët shtetas, të kallëzuar dhe nga z. A.Xh. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit të dytë penal, për të njëjtët autorë dhe për të njëjtën veprë penale, i ka bashkuar dy procedimet e regjistruara. Deklarimet e shtetasve M. D., J. B. janë marrë respektivisht për secilin prej tyre më datë 10.01.2014 dhe më datë 15.01.2014, pasi ishte regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme ankesa⁵⁷ e dërguar me *e-mail* nga A.Xh. dhe pak ditë para se subjekti i rivlerësimit të përcillte, për këtë ankesë, në Prokurorinë e Përgjithshme informacionin⁵⁸ për veprimet hetimore të kryera për këtë procedim penal.

79. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për gjykim për këtë procedim penal pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda më datë 10.03.2015, duke kërkuar dënimin e shtetasve E. M. dhe K. D. për të dyja procedimet penale të regjistruara. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. {***}, datë 25.05.2015, ka konstatuar se: *[...] Në rastin objekt gjykimi nuk ka deklarime të shtetasit A.Xh., sipas parashikimeve të nenit 294/1/b të Kodit të Procedurës Penale, pra nuk është realizuar pyetja e tij për faktin penal që ka referuar, kallëzuar në policinë gjyqësore. Në këto kushte, kur deklarimet e bashkëjetueses së shtetasit A.Xh., shtetas M. D., të punëdhënësit të tij J. B. nuk e konfirmojnë faktin penal të referuar, nuk kanë asnjë dëgjim për të [...], gjykata vlerëson se fakti penal i pretenduar nga Prokuroria për Krimet e Rënda lidhur me shtetasin A.Xh. nuk provohet se ekziston. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka deklaruar të pafajshëm të pandehurit për veprën penale të kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit A.Xh., pasi nuk provohet se fakti ekziston në bazë të nenit 388/1/a të Kodit të Procedurës Penale dhe ka shpallur fajësinë e këtyre shtetasve vetëm për rastin e kallëzimit të shtetasit E. H.*
80. Nga verifikimi i veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, sipas të dhënave të rezultuara nga aktet e dosjes të çështjes penale nr. {***}/2013, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer hetim në mënyrë shteruese të rastit dhe nuk ka vlerësuar rëndësinë e ngjarjes të denoncuar nga z.A.Xh., në raport me rrezikshmërinë e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal. Subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar për të marrë në pyetje kallëzuesin e veprës penale, mosveprime të cilat në gjykimin e çështjes kanë çuar në shmangien nga dënimi më i rëndë i autorëve të kryerjes së veprës penale. Pasojat e veprës penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për marrjen e pasurisë”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b/1-25 i Kodit Penal, kanë qenë të një rrezikshmërie më të lartë në rastin e shtetasit E. H., duke shkaktuar pasoja më të rënda pasurore dhe sociale për personat e përfshirë. Në rastin e shtetasit E. H., ngjarja ka ndodhur në qershor të vitit 2013, më parë në kohë se sa ajo e ndodhur z. A.Xh., në korrik 2013, pavarësisht se kallëzimi nga z. E. H. është bërë më vonë në kohë se sa ai i z. A. Xh. Në këtë kuptim, në ndryshim nga Komisioneri Publik, i cili në ankim ka çmuar se mosveprimet e subjektit të rivlerësimit kanë sjellë pasoja të rënda për shtetas të tjerë, të cilat eventualisht mund të ishin shmangur në rast të hetimit të plotë të kallëzimit të depozituar nga z. A.Xh., trupi gjykues vlerëson se mosveprimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë ndikuar në ardhjen e pasojave të veprës penale kundrejt z. E. H., pasi këto pasoja kanë ndodhur në muajt qershor-korrik 2013, referuar kontratave përkatëse të shitblerjes së autoveturës dhe apartamenteve të përfituara nga të kallëzuarit prej shtetasit E. H.

⁵⁷Sipas akteve të fashikullit të hetimit, ankesa e z. Xh. është regjistruar në datën 06.01.2014.

⁵⁸ Informacioni është i datës 17.01.2014.

81. Në vlerësim të kësaj situatë faktike, trupi gjykues çmon se rrethanat e analizuarra më sipër nuk janë të mjaftueshme për t'u vlerësuar sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për pasojë trupi gjykues nuk mund të konkludojë se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016.
82. Në lidhje me shkakun e ankimit të parashtruar nga Komisioneri Publik, sipas të cilit *rasti i trajtuar në ankimin me nr. {***}, datë 26.01.2015, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijëni Inspektorit të Etikës pranë Prokurorit të Përgjithshëm, duhet trajtuar si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të profesionit, parashikuar nga neni 103 i ligjit nr. 96/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka realizuar komunikime të papërshtatshme dhe në shkelje të etikës, sjellje kjo në kundërshtim me rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve*, trupi gjykues konstaton se në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni, në vendim, nuk e ka trajtuar rastin e referuar nga ankimi i Komisionerit Publik, edhe pse ka qenë pjesë e analizës së raportit të vlerësimit të GPPP-së, në rubrikën "Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme". Sipas raportit të GPPP-së, avokate E. Ç. i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijëni Inspektorit të Etikës pranë Prokurorit të Përgjithshëm, nisur nga një shqetësim i cili ka ndodhur në emisionin e përjavshëm të saj "Shihemi në gjyq", që shfaqet në Televizionin Kombëtar Klan, pasi ka marrë një mesazh kërcënues në numrin e saj privat nga numri i telefonit në përdorim të prokurorit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, subjektit të rivlerësimit Anton Martini, duke kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj këtij të fundit. Oficeri i Policisë Gjyqësore i ngarkuar me trajtimin e ankimit, më datë 26.01.2015, ka kryer këqyrjen e një aparati telefonik *iPhone 4s*, për të evidentuar mesazhe të shkëmbyera ndërmjet numrit të telefonisë celulare, që i përket avokates E. Ç. dhe numrit të telefonisë celulare, që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Martini. Nga këqyrja e telefonit janë gjetur shtatë mesazhe, të cilat kanë rëndësi për ankesën dhe përmbajtja e tyre është pasqyruar në mënyrë integrale në raportin e hartuar nga GPPP-ja⁵⁹, nga të cilët trupi gjykues evidenton njërin prej tyre, i cili duket se ka qenë objekt ankimi i avokates E. Ç. Subjekti i rivlerësimit i drejtohet avokates: *Znj. E. përshëndetje! Jam Anton Martini, kushëriri i V. M. Pashë emisionin sot, na kishte premtuar se nuk do të kishte emision të dytë kundër V. Se si doli emisioni, kush predominoi, kush ishte shtytësi, përfituesi etj., e kuptuam. Kush prishi marrëveshjen e bërë më parë, u verifikua. Kush desh të na fyejë me patjetër, u mor vesh. Diçka të dish ti: nuk jemi të pa farë në këtë botë, nuk dimë të sillemi vetëm me edukatë, por dimë të sillemi edhe si kafshë, para kafshëve të të gjitha llojeve qofshin ato.* Në vazhdimin e komunikimit, subjekti i rivlerësimit, pas komunikimit të avokates se mesazhi i tij është kërcënues dhe ajo do të ndërmarrë hapat e nevojshëm, në mesazhet vijuese shprehet se ai nuk kishte ndërmend të bënte asnjë kërcënim, por vetëm të sqaronte situatën e kushëririt të tij, meqenëse kishte pasur edhe një takim me avokaten në zyrën e saj. Gjatë kryerjes së veprimeve verifikuese, GPPP-ja ka konstatuar se në praktikën e rastit gjendet i administruar, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Martini, një sqarim "Mbi ankesën e paraqitur nga znj. E. Ç.", drejtuar Inspektorit të Etikës, prej 4 faqesh. Gjithashtu konstatohet se subjekti i rivlerësimit Anton Martini ka dorëzuar pranë Inspektorit të Etikës edhe një ankesë, "Mbi një histori të bërë publike në një emision televiziv", ku më parë rasti është sqaruar nga hetimi penal dhe nga gjykimet civile dhe penale, të cilën noter V. M. ia ka drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijëni Dhomës Kombëtare të Noterisë Tiranë. Sipas raportit të GPPP-së, pasi janë kryer veprimet e sipërpërkruara dhe janë administruar aktet e mësipërme, ankimi është arkivuar më datë 21.01.2016, në gjendjen që janë aktet, pa kthyer ndonjë përgjigje, duke mos vlerësuar se mbi këto të dhëna ka vend për kthim përgjigjeje.

⁵⁹ Përmbajtja e mesazheve është pasqyruar në faqen nr. 52 të raportit të GPPP-së.

83. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni është shprehur: *Nga ankesat e depozituara në Prokurorinë e Përgjithshme vërehet një rast, ku znj. E.Ç. është ankuar në Prokurorinë e Përgjithshme për shkelje të etikës nga ana juaj dhe ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj jush. Kjo ankesë është depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme në janar të vitit 2015. Nga verifikimi i kësaj ankese, rezulton se janë kryer veprime verifikuese dhe se ju keni dhënë sqarimet tuaja para Inspektorit të Etikës pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Pavarësisht shqyrtimit të ankesës në Prokurori të Përgjithshme, nga Inspektori i Etikës, nuk rezultoi që ndaj jush të ketë filluar procedim disiplinor për këtë ankesë.*
- Nga sa më sipër, rezulton se Komisioni nuk ka vlerësuar se duhet t'i kalojë barrën e provës subjektivit të rivlerësimit, lidhur me këtë ankesë, duke mos e vlerësuar atë të tillë që të sjellë pasojë në procesin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektivit të rivlerësimit. Edhe në shpjegimet e subjektivit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, nuk gjenden sqarime apo shpjegime në lidhje me këtë ankesë.
84. Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në ankim, dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, parashtroi se rasti konkret dhe rrethanat e faktuara të kryerjes së tij, duhet të vlerësohen si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të profesionit, parashikuar nga neni 103 i ligjit nr. 96/2016, si dhe sjellje në kundërshtim me rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, pasi duket se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të marrë premtime në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë.
85. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në lidhje me këtë shkak ankimi, parashtroi se Komisioneri Publik pretendon në mënyrë të gabuar se veprimet e tij për ngjarjen e ndodhur në muajin janar 2015, duhet të konsiderohen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga ligji nr. 96/2016, i cili ka hyrë në fuqi më datë 22.11.2016, pra rreth dy vite pasi ngjarja kishte ndodhur, duke kërkuar kështu t'i japë fuqi prapavepruese këtij ligji. Subjekti i rivlerësimit parashtroi gjithashtu se referimi i bërë nga Komisioneri Publik te rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, është i pasaktë, pasi në rastin konkret subjekti i rivlerësimit as nuk ka kërkuar e as ka marrë ndonjë përfitim dhe ngjarja nuk ka asnjë lidhje me detyrën e tij si prokuror, as me ndonjë hetim të zhvilluar prej tij. I gjithë implikimi i subjektivit të rivlerësimit në këtë histori vinte si detyrim familjar për kushëririn e tij, pa shfrytëzuar në asnjë moment dhe pa kurrfarë lidhjeje me pozicionin e tij si prokuror, si dhe duke ruajtur etikën.
86. Në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se komunikimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet mesazheve telefonike me avokaten E. Ç., në kushtet kur ai nuk ishte duke ushtruar funksionin, pasi nga përmbajtja e të gjitha sms-ve duket qartë se marrëdhënia me avokaten është krijuar si pasojë e një problematike që lidhet me një të afërm të subjektivit të rivlerësimit, si dhe në kushtet kur komunikimi i dokumentuar në rastin në fjalë, është realizuar nga subjekti i rivlerësimit duke përdorur numrin zyrtar të telefonisë celulare të prokurorit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, i cili përcakton se: *Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.* Gjithashtu komunikimi i subjektivit të rivlerësimit bie në kundërshtim edhe me Rregullat e Etikës dhe Sjelljes së Prokurorëve⁶⁰, të cilat në nenin 3, pika “ë” parashikojnë se prokurorët, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, duhet: *Të jenë dhe të tregohen objektivë, të pavarur, të paanshëm, të shmangin*

⁶⁰Ndiq linkun: https://www.pp.gov.al/rc/doc/rregullat_e_etikes_dhe_sjelljen_e_prokuroreve_820_5019.pdf.

çdo papajtueshmëri me funksionin, të ndërgjegjshëm për detyrimet etike e profesionale dhe të veprorë në atë mënyrë që të nxisin besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre.

Trupi gjykues çmon të vlerësojë sjelljen e subjektit të rivlerësimit edhe sipas parashikimeve të shkronjës “dh” të nenit 103 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, sipas së cilës shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit të magjistratit janë, në veçanti, sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

87. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, teksa gëzonte funksionin e prokurorit, i ka dërguar shtatë mesazhe telefonike avokates E. Ç., me një përmbajtje që kishte për qëllim t’i tregonte asaj se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij ishin të zhgënjyer nga qëndrimi i saj, në disfavor të të afërmit të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në komunikimin mes tij dhe avokates në fjalë, duke mbajtur në konsideratë përmbajtjen dhe rrethanat e komunikimit, në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, përbëjnë sjellje që nuk i shërben këtij qëllimi. Në funksion të këtij konkluzioni, trupi gjykues çmon se në rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja, subjekti i rivlerësimit mund dhe duhet të kishte shmangur përfshirjen e tij në zgjidhjen e rastit në fjalë, pasi i afërmi i tij, i pretenduar si i dëmtuar nga pjesëmarrja në emisionin televiziv të avokates Ç., ishte i aftë të mbrohej personalisht pasi ushtron profesionin e noterit, e për më tepër kishte edhe ndihmën e të afërmit tjetër të tij i cili, sipas vetë deklarimeve të subjektit të rivlerësimit⁶¹, ishte avokat dhe kishte komunikuar paraprakisht me avokaten Ç. Përfshirja e subjektit të rivlerësimit në zgjidhjen e rastit në fjalë, krijon përshtypjen se ai ka pasur për qëllim të përdorë autoritetin e funksionit të prokurorit për të ndikuar mbi avokaten Ç., me qëllim përmbushjen e interesave të të afërmit të tij. Trupi gjykues vëren se shkelja e etikës jashtë ushtrimit të funksionit, qoftë kjo edhe në kontekstin e një situatë të marrëdhënieve familjare, cenon besimin e publikut sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në komunikimin e tij me avokaten Ç., me tone kërcënuese, subjekti i rivlerësimit ka reflektuar një qëndrim që cenon besimin e publikut te drejtësia.
88. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se veprimet e tij për ngjarjen e ndodhur në muajin janar 2015, nuk duhet të konsiderohen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga ligji nr. 96/2016, i cili ka hyrë në fuqi më datë 22.11.2016, pasi ligji nuk ka fuqi prapavepruese, nuk është i bazuar, pasi fuqia prapavepruese e dispozitave mbi shkeljet disiplinore, parashikohet nga neni 172, pika 3 e vetë ligjit nr. 96/2016, e cila përcakton se: “Për shkeljet disiplinore të parashikuara sipas këtij ligji, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, dhe që parashikoheshin si të tilla në kohën e kryerjes së tyre, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji [...]”.
89. Në lidhje me shkakun e ankimit të parashtruar nga Komisioneri Publik, sipas të cilit *për tri nga dosjet e përzgjedhura me short, pjesë e raportit të vlerësimit të hartuar nga GPPP-ja, Komisioni nuk ka trajtuar në vendim mangësitë procedurale të konstatuara dhe detyrimet/përgjegjësitë e mundshme të subjektit në hetimin e secilit prej rasteve*, trupi gjykues konstaton se në vendimin objekt shqyrtimi, në pjesën kushtuar arsyetimit për vlerësimin e aftësive profesionale, për dosjet e përzgjedhura me short pjesë e raportit të GPPP-së, Komisioni nuk ka konstatuar problematika thelbësore.
90. Në raportin e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Anton Martini, me nr. {***} prot., datë 07.06.2018, të GPPP-së, në rubrikën “Përshkrimi i pesë dosjeve penale të përzgjedhura me

⁶¹Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 01.06.2021.

short” për dokumentin e parë ligjor të përzgjedhur me short, dosja nr. 1, vendimi datë 1.9.2016 “Për mosfillimin e procedimit penal”, për kallëzimin nr. {***}, datë 19.04.2016, GPPP-ja ka konstatuar se aktet e kallëzimit penal janë referuar nga Komisariati i Policisë Shkodër, me shkresën nr. 3018, datë 19.04.2016, e mbi këtë bazë, më datë 19.04.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***}/2016të shtetasve U. Sh. dhe E. Sh., ndaj shtetasit Sh. I., për kundërvajtjet penale “Vetëgjyqësia” dhe “Kanosja”, parashikuar nga nenet 277 e 84 të Kodit Penal. Ushtrimi i ndjekjes penale është bërë nga subjekti i rivlerësimit, i cili është ngarkuar për ndjekjen e kallëzimit sipas shënimit të drejtuesit të Prokurorisë, më datë 23.04.2016. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka marrë për shqyrtim aktet e kallëzimit, si dhe ka kryer disa veprime verifikuese, duke vlerësuar se në kallëzimin e dy shtetasve të mësipërm nuk konstatohen elemente të ndonjë vepre penale, pasi ka argumentuar se konflikti i pretenduar në kallëzim është i natyrës juridiko-civile, duke sugjeruar se zgjidhja e konflikteve të tilla bëhet në gjykatë në rrugë civile, më datë 01.09.2016, ka vendosur: “Të mosfillojë procedimin penal mbi bazën e materialeve të referuara më datë 19.04.2016, me nr. 3018 prot., nga Komisariati i Policisë Shkodër. Të njohë me këtë vendim Komisionin e Policisë Shkodër, si dhe shtetasit U. Sh. dhe E. Sh. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër”.

Nga GPPP-ja është konstatuar se: “Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë me vonesë të pajustificueshme, duke kryer vetëm tri veprime hetimore, marrjen e tri deklarimeve me data 2.5.2016, 12.5.2016 dhe 23.5.2016, bazuar në relacionin pa datë të oficerit të Policisë Gjyqësore. Vendimi i mosfillimit nuk rezulton t’u jetë njoftuar shtetasve Sh. I. dhe I. I., pavarësisht se shtetasi I. I. më datë 18.04.2016 është pyetur nga Policia Gjyqësore në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, duke ardhur në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale”.

91. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit mbi këtë dosje penale⁶², ka shpjeguar se: *Është evident fakti se, në këtë rast, referuar udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, ku është përcaktuar si afat për verifikimin e kallëzimit jo më shumë se 30 ditë, nuk e kam respektuar. Pavarësisht se ligji procedural penal në këtë periudhë nuk na kufizonte në afate për marrjen e një vendimi të tillë, udhëzimi i mësipërm ka qenë në fuqi. Vendimmarrja ime për këtë rast pas afatit 30-ditor, nuk ka sjellë pasojë për sa u përket të drejtave të kallëzuesit, pasi vendimi i është njoftuar kallëzuesit, i cili nuk e ka ankimuar as në gjykatë dhe as te prokurori më i lartë. Vonesa e vendimmarrjes lidhur me rastin e mësipërm, nuk ka ardhur nga mosnjohja e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, por si rezultat i një dinamike në hetimin dhe gjykimin e shumë rasteve që isha i ngarkuar me ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në këtë periudhë, dhe prioriteteve që ndryshonin sipas ngjarjeve që trajtonim.*

Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin {***} prot., datë 21.11.2019, të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, sipas të cilit: *Prokurori*

⁶²Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me: “Vendimi “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin nr. {***}, datë 19.04.2016 është marrë me vonesë të pajustificueshme duke kryer vetëm tre veprime hetimore (tre deklarimeve me data 02.05.2016, 12.05.2016 dhe 23.05.2016), bazuar në relacionin pa datë të oficerit të policisë gjyqësore. Për periudhën e vlerësimit të materialit kallëzues nga ana juaj, në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale nuk ka pasur të përcaktuar afate kohore në lidhje me fazën e verifikimeve që mund të kryhen përpara se ju të vendosnit për zgjidhjen ligjore që do të marrë materiali kallëzues. Por, në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, është përcaktuar se “afati i verifikimit, të kallëzimit penal ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë. [...] Rezulton se ndaj vendimit të mosfillimit nuk është bërë ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër nga asnjëra nga palët”.

Anton Martini, gjatë periudhës nëntor 2015-dhjetor 2016 ka verifikuar 42 kallëzime, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal për 9 kallëzime për vitin 2015 dhe 33 kallëzime për vitin 2016. Gjatë kësaj periudhe ka pasur në hetim 169 procedime penale, 28 për vitin 2015 dhe 141 për vitin 2016, për të cilat janë marrë vendime gjykimi, pushimi, pezullimi apo ka vijuar hetimi. Nga procedimet e mësipërme, prokurori Anton Martini ka dërguar për gjykim dhe ka përfaqësuar akuzën në gjykim për 74 procedime penale”.

92. Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka argumentuar se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe të mbështetura ligjërisht. Mosrespektimi i afateve kohore për pushimin e procedimeve penale dhe mosnjoftimi i palëve të përfshira në një kallëzim penal për mosfillimin e procedimit, është në shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, që kanë qenë në fuqi në periudhën përkatëse.
93. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në kundërshtim të këtij shkakut ankimi, mbajti të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur gjatë hetimit administrativ në Komision, siç është pasqyruar në paragrafin 91 më sipër në këtë vendim.
94. Në analizë të këtij shkakut ankimi, në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik për mosrespektim të afateve kohore për pushimin e procedimit penal, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret, trupi gjykues vëren se ligji i kohës – Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar, në versionin në fuqi në shtator të vitit 2016 – nuk parashikon afate kohore për verifikimin e kallëzimit që duhet të kryhet nga prokurori përpara se ai të vendosë për zgjidhjen ligjore të çështjes. Këto afate janë trajtuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar⁶³, i cili parashikon në pikën 2 të tij: *2.1 Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitet të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. 2.2 Në raste të veçanta, kur megjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar – në pikën 2.1 të sipërpërmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë. 2.3 Gjatë periudhës 30 ditore, të parashikuar në pikën 2.2 të këtij udhëzimi, prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.*

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, duke vendosur më datë 01.09.2016, mosfillimin e procedimit penal mbi bazën e materialeve të referuara më datë 19.04.2016 nga Komisariati i Policisë Shkodër, pra rreth 4 muaj më vonë, ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin e sipërcituar të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka qenë i detyrueshëm për zbatim.

Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se vonesa e vendimmarjes lidhur me rastin e mësipërm ka ardhur si rezultat i një ngarkese të madhe në atë periudhë, nuk duket bindës, pasi veprimet e kryera nga subjekti i

⁶³ I ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 27.10.2006 dhe udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012 të Prokurorit të Përgjithshëm.

rivlerësimin në verifikimin e rrethanave [marrja e deklarimeve] sipas nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, janë kryer brenda muajit maj 2016, brenda afatit të përcaktuar në udhëzim, duke qenë në vonesë vetëm vendimmarrja e tij, e cila lidhet me vlerësimin e prokurorit pas kryerjes së veprimeve hetimore. Edhe argumenti tjetër i përdorur nga subjekti i rivlerësimin se vonesa në marrjen e vendimit nuk ka sjellë pasoja për sa u përket të drejtave të kallëzuesit, pasi vendimi i është njoftuar kallëzuesit i cili nuk e ka ankimuar as në gjykatë dhe as te prokurori më i lartë, nuk është bindës, pasi zbatimi i afateve procedurale është një detyrim që duhet zbatuar, që lidhet me garantimin e së drejtës së ankimit, pavarësisht ushtrimit apo jo të kësaj të drejte nga palët në proces.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimin ka qenë në kushtet e mosrespektimit të afatit kohor për mosfillimin e procedimit penal në rastin konkret, afat i përcaktuar nga udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm.

95. Në analizë të pretendimit tjetër të Komisionerit Publik, se mosnjoftimi i palëve të përfshira në një kallëzim penal për mosfillimin e procedimit, është në shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret, trupi gjykues vëren se ligji i kohës – Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar, në versionin në fuqi në shtator të vitit 2016 – neni 291 i tij, “Vendimi për mosfillimin e procedimit”, parashikon se: *1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.*

Gjithashtu, vendimi unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: *17. Lind pyetja, nëse në radhët e subjekteve që veprojnë në këtë fazë, a duhet të përfshihet edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale? Duke qenë se ai mund të ketë interesa në këtë proces, a duhet t’i njoftohet dhe a ka ai të drejtën e ankimit ndaj vendimit? Faza e fillimit të procedimit penal është e lidhur kryesisht me verifikimin e kushteve dhe rrethanave që nuk lejojnë fillimin e hetimeve në drejtim të personit të dyshuar apo atij të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal nuk prek interesa të personit që i atribuohet vepra penale. Në këtë kuptim, nuk mund të ketë ndonjë arsye që ky person të bëjë ankim kundër vendimit të mosfillimit. Në bazë të nenit 291 të K.Pr.Penale, të legjitimuar për të paraqitur ankim janë vetëm kallëzuesi ose i dëmtuari ankues, sipas përcaktimeve të parashikuara prej nenit 284 të K.Pr.Penale. 18. Të drejtën e ankimit dhe për rrjedhojë, edhe legjitimimin për të ankimuar vendimin e mosfillimit, Kodi i Procedurës Penale ia njeh, përveç subjektit të “dëmtuar akuzues”, që në bazë të nenit 58 të K.Pr.Penale, si pasojë e veprës penale ka të drejtë që të paraqesë kërkesë për fillimin e procedimit penal dhe të ngrejë akuzë drejtpërsëdrejti në gjykatë, edhe atyre subjekteve të dëmtuara pa ankimin e të cilëve nuk mund të fillojë procedimi penal, e kur ka filluar nuk mund të vazhdojë, në bazë të nenit 284 të K.Pr.Penale.*

19. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke qartësuar, arrijnë në konkluzionin logjik se: sipas nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori duhet t’i njoftojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duke i dhënë mundësinë për t’u ankuar kundër këtij vendimi, kallëzuesit të veprës penale, i cili mund të jetë, rast pas rasti, edhe i dëmtuari nga vepra penale, si edhe ankuesit, kur ka të tillë, në kuptim të nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se disponimi i subjektit të rivlerësimin në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, për njohjen me këtë vendim vetëm të Komisarariatit të Policisë Shkodër, si dhe shtetasve U. dhe E. Sh., është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, në kohën e marrjes së vendimit.

96. Në lidhje me dokumentin e dytë ligjor të përzgjedhur me short, dosja nr. 2, procedimi penal nr. {***} i vitit 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, trupi gjykues vëren se GPPP-ja ka konstatuar se procedimi penal nr. {***}/2013 është regjistruar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda më datë 27.05.2013, mbi bazën e materialeve të referuara nga Sektori kundër Narkotikëve në Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal. Në të njëjtën datë, pas vendimit për regjistrimin e këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Më datë 20.09.2013, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur: *Pushimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. {***}/2013, pasi fakti nuk ekziston. Të njohë me këtë vendim Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga e cila ka ardhur materiali referues.*
- Në vazhdim, GPPP-ja ka vlerësuar se, përsa i përket zgjidhjes së procedimit penal me pushimin e hetimeve, vendimmarrja e prokurorit është e drejtë, por konstatohet se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me dispozitën ligjore për të cilën është vendosur pushimi i hetimeve dhe vendimi i pushimit nuk i është dërguar me shkresë kësaj drejtorie apo personit ndaj të cilit janë zhvilluar hetime.
97. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit⁶⁴, ka shpjeguar se: *Sektori kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve që kishte referuar aktet, bënte pjesë brenda Drejtorisë Kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Gabimisht jam shprehur për Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, por në fakt ishte Sektori kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Drejtorinë kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Oficeri i Policisë Gjyqësore, z. E. H., i cili referoi rastin dhe kreu hetimet deri në fund të tyre, ishte oficer i Policisë Gjyqësore në Sektorin kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Drejtorinë kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ai është njohur me vendimmarrjen time, pasi ishte oficeri i Policisë Gjyqësore që hetoi rastin. Nuk është në praktikën tonë që të dërgojmë njoftime për vendimmarrjet tona, kur oficeri i Policisë Gjyqësore që ka referuar rastin, ka kryer vetë hetime dhe është në dijeni të të gjitha rezultateve të hetimit. Ai dhe zyra e tij, që e ka referuar rastin, ka kryer vetë hetime dhe është në dijeni të të gjitha rezultateve të hetimit.*
98. Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka argumentuar se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe të mbështetura ligjërisht, pasi mosnjoftimi i palëve për pushimin e procedimit, është në shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, që ka qenë në fuqi në periudhën përkatëse.
99. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në kundërshtim të këtij shkakut ankimi, mbajti të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur gjatë hetimit administrativ në Komision, siç është pasqyruar në paragrafin 97 më sipër në këtë vendim.
100. Në analizë të këtij shkakut ankimi, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret, trupi gjykues vëren se ligji i kohës – Kodi i

⁶⁴Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me: “[...] Së pari, konstatohet se materiali referues nuk ka ardhur nga Drejtoria Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, por nga Departamenti Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe, si rrjedhojë, në pikën 2 të vendimit të pushimit, duhej të citohej Drejtoria, e cila ka bërë referimin; së dyti, konstatohet se vendimi i pushimit nuk i është dërguar me shkresë kësaj drejtorie, por as Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, të cituar në vendimin e pushimit [...]”.

Procedurës Penale, i ndryshuar, në versionin në fuqi në shtator të vitit 2016 – në nenin 329 të tij⁶⁵ parashikon se kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. Ndërsa vendimi unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: *30. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke qartësuar arrijnë në konkluzionin njësuessë: të drejtën për të paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes penale, e ka vetëm personi i dëmtuar nga vepra penale, subjekt ky që mund të jetë njëherazi edhe kallëzues, por kallëzuesit që nuk janë të dëmtuar nga vepra penale nuk legjitimohen nga ligji procedural penal të ushtrojnë të drejtën e ankimit sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale.* Sa më sipër, fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer njoftimin e Sektorit Kundër Narkotikëve në Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në thelb nuk sjell asnjë pasojë në drejtim të ushtrimit të së drejtës së ankimit, pasi ky organ nuk legjitimohet të bëjë ankim. Gjithashtu, duke qenë se nuk ka pasur të regjistruar emra të personave që iu atribuohet vepra penale, nuk ka pasur subjekte të tjera për t'u njoftuar. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, por administrativisht, ai duhet të ishte kujdesur për njoftimin e Sektorit referues, pasi kështu kishte disponuar në vendimmarrjen e tij.

101. Në lidhje me dokumentin e tretë ligjor të përzgjedhur me short, dosja nr. 3, procedimi penal nr. {***} i vitit 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, trupi gjykues konstaton se GPPP-ja ka konstatuar se kallëzimi penal është regjistruar pranë kësaj prokurorie më datë 05.04.2013, mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, për veprën penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit”, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 298 dhe 333/a të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, më datë 27.12.2013, ka vendosur: *Pushimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. {***/2013, pasi fakti nuk ekziston. Të njohë me këtë vendim Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda afatit ligjor.*

Nga GPPP-ja është vlerësuar se: *[...] Në pikën 2 të vendimit të pushimit është cituar: “të njohë me këtë vendim Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, por konstatojmë se vendimi i pushimit nuk i është dërguar me shkresë kësaj drejtorie apo personit ndaj të cilit janë zhvilluar hetime [...].*

102. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me sa është konstatuar nga raporti i GPPP-së.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se: *[...] Oficeri i Policisë Gjyqësore që kreu hetime dhe përpiloi të gjitha aktet deri në relacionin për pushim vinte nga radhët e Policisë së Shtetit, z. A. H. Pavarësisht se në vendimmarrjet e mia jam shprehur për njoftimin e sektorëve përkatës, fakti se hetimi është kryer nga oficeri i policisë gjyqësore i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konsiderohet i ezauruar ky njoftim, sepse ata raportojnë në mënyrë sistematike në fund të hetimeve për rezultatet e punës në strukturat nga vijnë. [...] E drejta e njoftimit lidhet thelbësisht me të drejtën e ankimit, për pasojë Policia e*

⁶⁵Neni 329, “Ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes”, i Kodit të Procedurës Penale parashikon:

“1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri.

2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit, vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit, ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin.

3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri”.

Shtetit nuk legjitimohet të ankimojë një vendim pushimi, të cilin e ka referuar ajo dhe është involvuar në kryerjen e veprimeve hetimore.

Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nr. {***} prot., datë 18.11.2019, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas të cilit z.A. H. ka qenë punonjës policie, me detyrë oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit deri më datë 13.10.2019.

103. Në ankim, por edhe gjatë gjykimit në Kolegj, Komisioneri Publik, në lidhje me këtë dokument, ka parashtruar të njëjtat pretendime si për dokumentin e dytë ligjor të përzgjedhur me short, të analizuar në paragrafin 98, më sipër në këtë vendim, dhe subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, mbajti qëndrim të njëjtë me atë të shprehur gjatë hetimit administrativ në Komision, të pasqyruar në paragrafin 102, më sipër në këtë vendim.

Në kushtet kur dhe vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit dhe pretendimet e Komisionerit Publik janë të njëjta me ato për dokumentin e dytë ligjor të zgjedhur me short, trupi gjyqësor vlerëson të mbajë të njëjtin qëndrim si në paragrafin 100, më sipër në këtë vendim.

104. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjyqësor, në analizë të fakteve dhe rrethanave të pasqyruara e analizuar më sipër, vlerëson se veprimet e mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit nuk janë të një rëndësie të tillë sa të gjejë zbatim neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

105. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *për denoncimin nr. {***} prot., datë 11.12.2019, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve shtesë të hetimit, pasi nuk dokumentoi procedurat e hedhjes së shortit dhe mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të strukturës përkatëse*, trupi gjyqësor konstaton si vijon.

Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatohet se në denoncimin me nr. {***} prot., datë 11.12.2019⁶⁶, denoncuesja, znj. L. M., ka pretenduar në mënyrë të përmbledhur se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka kryer shkelje të rënda, pasi ua ka hequr dosjet hetimore disa prokurorëve, duke ua kaluar prokurorëve të tjerë, pa dhënë dorëheqjen të parët dhe pa një vendim që të justifikonte kalimin e dosjeve hetimore nga njëri prokuror te tjetri. Gjatë drejtimit të tij në Prokurorinë e Shkodrës, gjenden edhe shkelje të tjera, siç është dërgimi i dosjeve në gjykatë pa pyetur asnjëherë kallëzuesin dhe pa e vënë në dijeni për dërgimin e çështjeve për shqyrtim.

106. Pas shqyrtimit të këtij denoncimi, Komisioni ka konkluduar në vendim⁶⁷ se: *Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, konstatohet se: (i) në çdo rast kanë ekzistuar shkaqet ligjore mbi bazën e të cilave, në kuadër të kompetencave që i jep ligji, z. Anton Martini, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur zëvendësimin e prokurorëve në hetimin apo përfaqësimin në gjykim të çështjeve përkatëse; (ii) nuk rezulton të ketë pasur ndonjë rast ankimi ndaj vendimit të zëvendësimit; si dhe (iii) referuar informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për rastet e zëvendësimit, ndarja e dosjeve është bërë me short manual dhe në mënyrë proporcionale. Për më tepër, në kushtet kur*

⁶⁶Më datë 11.12.2019, një ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, në Komisionin është depozituar një denoncim i ri për subjektin e rivlerësimit. Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm për verifikimin e pretendimeve të parashtruara në denoncimin e depozituar rishtazi, me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 11.12.2019, Komisioni ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini, i cili ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 21.01.2020. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave shtesë të vëna në dispozicion nga subjekti, seanca e dytë dhe e fundit dëgjimore, është zhvilluar në datën 27.01.2020.

⁶⁷ Paragrafët 49.19 dhe 49.20 të vendimit të Komisionit nr. 231, datë 29.01.2020.

denoncuesi nuk paraqet rrethana apo fakte konkrete mbi bazën e të cilave të provohet dyshimi për qëllimin e fshehur në përpilimin e këtyre vendimeve të zëvendësimit të prokurorit dhe në kushtet kur as Komisioni nuk evidentoi situata të dyshimta në shpërndarjen e dosjeve dhe përpilimin e vendimeve të zëvendësimit, trupi gjykues vlerëson se trajtimi i këtij denoncimi merr një peshë specifike më të vogël, pasi ka të bëjë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë etiko-profesionale të tij apo integritetin dhe figurën si prokuror, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka qenë vetëm për rreth 7 muaj drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në rreth 21 vite karrierë si prokuror – periudhë rivlerësimi.

107. Trupi gjykues vëren se rrethanat e denoncuara nga znj. L. M., janë të ngjashme me ato të denoncuara nga një denoncues anonim, denoncimi i të cilit është përcjellë në Kolegj nga Institucioni i Komisionerëve Publikë dhe është protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.2021. Verifikimi i rrethanave të këtij denoncimi përbën shkakun tjetër të ankimit të Komisionerit Publik. Sipas denoncuesit anonim, *Anton Martini për shtatë muaj rresht nuk ka hedhur shortin në prokurorinë e Shkodrës, çështjet i ka shpërndarë sipas dëshirës dhe interesave të tij [...]. Kjo është plotësisht e verifikueshme, pasi nuk ka praktikë shorti, por ka vetëm siglime nëpër dosje. Shumë dosje të krimeve të rënda ua ka kaluar për kompetencë prokurorëve të tij të besuar, pa short.*
108. Duke konstatuar se rrethanat e parashtruara për verifikim në të dyja denoncimet kanë si objekt procedurën e hedhjes së shorteve, caktimit të çështjeve dhe zëvendësimit të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i komanduar në detyrën e drejtuesit të kësaj prokurorie, trupi gjykues vlerësoi se verifikimi dhe analizimi i objektit të sipërcituar do t'u japë përgjigje të dyja shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik.
109. Komisioneri Publik, në lidhje me objektin e denoncimeve të mësipërme, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, parashtrori se ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, pasi ka vlerësuar se rezultatet e hetimit shtesë administrativ mbi këtë denoncim, në asnjë rast nuk mund të trajtohen si të një peshe specifike më të vogël, me arsyetimin se kanë të bëjnë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë e tij etiko-profesionale si prokuror. Komisioneri Publik ka vlerësuar se çdo rrethanë që lidhet me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht kohës së shkurtër në detyrë, ka rëndësinë e vet dhe duhet të ketë vlerën e provës. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve shtesë të hetimit, pasi:
- a) subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, nuk dokumentoi procedurat e hedhjes së shortit, procedura për të cilat Komisioni vetë ka konstatuar që statistikisht nuk ka të ngjarë që në 12 raste të zëvendësimit që i referohen shortit manual, të përzgjidhet me short i njëjti prokuror, si dhe duket se statistikisht nuk ka të ngjarë që nga 13 dosje për të cilat zëvendësimi është bërë për shkak të caktimit të dy prokurorëve në GPPP, në 10 prej tyre të përzgjidhet i njëjti prokuror;
 - b) subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, nuk dokumentoi mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të strukturës përkatëse, e cila sipas nenit 55/2/c të ligjit nr. 97/2016, jep mendim për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre;
 - c) nga hetimi gjyqësor në Kolegj, rezulton se, për numrin më të madh të kallëzimeve, nuk është dokumentuar shortimi i tyre si manualisht edhe elektronikisht, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur parashikimet ligjore dhe nënligjore në lidhje me përgjegjësitë e drejtuesit të prokurorisë.

110. Komisioni, në kuadër të hetimit shtesë administrativ të kryer për të verifikuar të dhënat e këtij denoncimit të znj. L. M., ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër informacionin mbi të gjitha rastet e zëvendësimit të prokurorit dhe 56 vendimet përkatëse⁶⁸, që i përkasin periudhës 10.11.2017 - 06.06.2018, gjatë së cilës drejtues i komanduar i kësaj prokurorie ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, vendime të cilat janë nënshkruar prej tij.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit administrativ të Komisionit⁶⁹, ka shpjeguar se:[...] Në përfundim të vitit 2017, pasi u nxorën dhe u përpunuan statistikatat mbi ngarkesën që kishte pasur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe problematikat e konstatuara gjatë atij viti, u vlerësua, me qëllim përmirësimit e punës për vitin në vijim, riorganizimi i seksioneve brenda Prokurorisë. Në këto kushte, më datë 16.1.2018, me urdhrin nr. {***}, me cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, bazuar në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 19.12.2016, “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”, dhe nr. {***}, datë 29.11.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, urdhërova riorganizimin e seksioneve dhe ripozicionova si Drejtuesit e Seksioneve, Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore. [...] Lidhur me mënyrën e ndarjes së procedimeve penale gjatë periudhës që kam qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dua t’ju sqaroj se dosjet dhe materialet e tjera kallëzuese apo referuese janë hedhur në short elektronik. Në raste të rralla që ka pasur problem teknik sistemi (i cili monitorohet nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm), materialet janë hedhur në short manual midis prokurorëve të seksionit, sipas grup-veprave penale. Gjithashtu, në rastet e largimit të prokurorëve, komandimit të tyre në prokurori të tjera apo në rastet e ndryshimit të seksioneve apo heqjes dorë të prokurorit nga një çështje e caktuar, dosjet hidhen në short manual, pasi sistemi elektronik nuk parashikon rihedhje në short elektronik. [...] Lidhur me trajtimin e kërkesave të shtetasve D. N. dhe M. S. (të pandehur) dhe të prokurorit F. L., për heqjen dorë nga vazhdimi i përfaqësimit të akuzës në gjyq, mendoj se e kam trajtuar me objektivitet dhe palët kanë ardhur në dijeni të vendimmarrjes sime, vendimmarrje e cila ka shoqëruar përfaqësimin e akuzës në gjyq nga një prokuror tjetër, e konkretisht nga prokurori Xh. L. në seancën e radhës, ku ankuesit duhet të ishin të pranishëm. Në asnjë rast nuk ka pasur ankesa të administruara për zëvendësim prokurorësh nga hetimet apo gjykimet e çështjeve për periudhën nëntor 2017-qershor 2018⁷⁰.

⁶⁸ Informacioni është përcjellë në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 16.12.2019 dhe shkresën nr. {***} prot., datë 23.12.2019.

⁶⁹ Në rezultatet e hetimit shtesë administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në lidhje me: “Nga vlerësimi në tërësi i rasteve të zëvendësimit të prokurorit, duket se ekzistojnë shkaqet ligjore të zëvendësimit, mbi bazën e të cilave në kuadër të kompetencave, sipas legjislationit në fuqi, ju në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë Shkodër keni vendosur zëvendësimin e prokurorëve në hetimin apo përfaqësimin në gjykim të çështjeve përkatëse dhe se nuk rezulton të ketë pasur ndonjë rast ankimi ndaj vendimit të zëvendësimit. [...] Komisioni kërkon të jepni shpjegime mbi hapat e ndërmarrë nga ana juaj për riorganizimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe respektimin e kriterëve ligjore në procedurën e rishpërndarjes së çështjeve nga ana juaj, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, konkretisht:

1. për kriteret organizative/ligjore mbi bazën e të cilave keni bërë riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (referuar urdhrin nr. {***}, datë 16.1.2018) – si pasojë e të cilit kanë ardhur dhe disa zëvendësime prokurorësh;
2. për procedurat e shortit të zhvilluara për rishpërndarjen e dosjeve, mbi bazën e të cilit janë bërë vendimet e zëvendësimit, si edhe nëse ka pasur trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit dhe seksionin përkatës;
3. nga verifikimi i rasteve të zëvendësimit, konstatohet se, në një rast zëvendësimi është bërë pa short, për shkak të kërkesës së të pandehurve, shtetasve D. N. dhe M. S. dhe kërkesës për dorëheqje nga vetë prokurori i çështjes F. L. nga përfaqësimi i akuzës në gjyq që ka të bëjë me të njëjtën çështje”.

⁷⁰ Këtë qëndrim subjekti i rivlerësimit e ka shprehur edhe në seancën dëgjimore të datës 27.01.2020 në Komision.

111. Gjatë gjykimit në Kolegj, pas zhvillimit të debatit gjyqësor mbi aktet e administruara nga hetimi kryesisht i Kolegjit, në lidhje me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim me atë të shprehur si më sipër, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit.
112. Në përfundim të hetimit gjyqësor të kryer në Kolegj për të verifikuar faktet e pretenduara në denoncime⁷¹, trupi gjykues, nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër⁷², konstaton si vijon.
- Në periudhën 10.11.2017-06.06.2018, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer detyrën e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, janë regjistruar 1503 kallëzime.
 - Me urdhrin nr. {***}, datë 16.01.2018, “Për riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, është bërë riorganizimi i seksioneve të prokurorisë. Nga data e nxjerrjes së këtij urdhri deri në datën 06.06.2018, kur subjekti është larguar nga detyra e drejtuesit, janë regjistruar rreth 1052 kallëzime, të cilat janë ndarë ndërmjet prokurorëve të seksioneve të saj, bazuar në urdhrin e mësipërm. Sistemi elektronik CAMS ka pasur probleme gjatë periudhës dhjetor 2017-shkurt 2018, për pasojë kallëzimet janë hedhur me short manual, ose edhe kur ka punuar sistemi dhe shorti është hedhur në formë elektronike, databaza e sistemit është dëmtuar dhe disa çështje janë fshirë e nuk janë rikthyer më në sistemin elektronik. Për periudhën e mësipërme nuk disponohet dokumentacion i plotë i akteve në lidhje me procedurat e hedhjes së shorteve ose caktimit të çështjeve apo zëvendësimit të prokurorëve, pasi nuk janë ruajtur në mënyrë sistematike procesverbalet e shortit manual dhe elektronik nga punonjësit e ngarkuar për mbajtjen e tyre.
 - Në periudhën 10.11.2017-06.06.2018, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer detyrën e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, janë shpërndarë nëpërmjet shortit të sistemit elektronik CAMS, 346 kallëzime nga 1503 kallëzime të regjistruara gjatë kësaj periudhe. Për rreth 1100 kallëzime, nuk rezulton të jetë dokumentuar shortimi i tyre si manualisht, ashtu dhe elektronikisht.
113. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të Komisionerit Publik, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me to, në analizë të situatës faktike të pasqyruar më sipër, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, vëren se ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 97/2016”), në nenin 21, pika 1, “Seksionet e prokurorive”, parashikon se: *1. Në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, drejtuesi i prokurorisë krijon seksione me jo më pak se tre prokurorë, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve.* Subjekti i rivlerësimit, megjithëse në preambulën e urdhrin nr. {***}, datë 16.01.2018, ka referuar si bazë ligjore ligjin nr. 97/2016, në shpjegimet e tij nuk është përgjigjur në lidhje me marrjen e mendimit të mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të prokurorisë përkatëse, në zbatim të detyrimit ligjor të cituar më sipër.
- Ligji nr. 97/2016, në nenin 42, në shkronjat “c”, “f”, “h”, përcakton ndër kompetencat e drejtuesit të prokurorisë dhe: “c) organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, që përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me këtë ligj; [...]
- f) mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e administratës së prokurorisë për veprimtaritë që nuk lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, në rast se nuk është parashikuar ndryshe me ligj; [...]

⁷¹ Siç është pasqyruar në paragrafin 25 të këtij vendimi.

⁷² Informacioni është përcjellë në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 30.04.2021.

h) siguron përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori; [...]”.

Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, në kreun II, pika 2, përcakton: “[...] procedura e shortit duhet të jetë e monitorueshme, e dokumentuar dhe transparente nëpërmjet njoftimit paraprak për zhvillimin e tij”, ndërsa në Kreun V, pika 3 parashikon: “Deri në realizimin teknik dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit, procedurat e shortit do të jenë manuale”.

114. Në verifikimin e zbatimit të parashikimeve ligjore të mësipërme në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar në përmbushjen e detyrave të drejtuesit të prokurorisë mbi organizimin dhe shpërndarjen e çështjeve prokurorëve nëpërmjet një procedure shortimi transparente dhe të dokumentuar. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, se dokumentimi i procedurës së shorteve është detyrë e administratës së prokurorisë, trupi gjykues vlerëson se ka qenë detyra e tij, si drejtues, të mbikëqyrte përmbushjen e detyrave funksionale të kësaj administrate dhe të ngarkonte me përgjegjësi personat përgjegjës për mosruajtjen sistematike të procesverbaleve të shortit manual dhe elektronik, e konstatuar kjo mungesë në 1100 kallëzime nga 1503 të regjistruara gjithsej. Trupi gjykues vlerëson se moszbatimi i ligjit nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, në lidhje me shpërndarjen e çështjeve në mungesë të një procedure transparente e të bazuar në kritere objektive, i konstatuar si pasojë e hetimit të fakteve të denoncuara nga publiku pranë institucioneve të rivlerësimit, ka cenuar besimin e publikut në punën e prokurorisë, pasi shortimi i kallëzimeve mbi kritere objektive dhe transparente, i bën individët të ndihen më të sigurt dhe më të lirë për të kontaktuar prokurorinë, për të kallëzuar krimet, për të bashkëpunuar në hetime dhe për të mbështetur punën e prokurorisë. Gjithashtu, kjo mënyrë veprimi e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka ndikuar dhe në perceptimin e prokurorëve të tjerë në këtë prokurori, në lidhje me zbatimin e ligjit. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se veprimet e mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, ashtu siç janë analizuar më sipër, përbëjnë shkak që ai të gjendet në kushtet e aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
115. Trupi gjykues kreu hetime⁷³ edhe në lidhje me rrethanën e denoncuar në denoncimin anonim, i protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 12.02.2021, sipas së cilës, subjekti i rivlerësimit ka ndikuar në lirimin e individit A. G., i vetmi që u lirua nga grupi i B. Nga aktet e përcjella në Kolegj nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe nga informacioni i drejtuesit të kësaj prokurorie⁷⁴, në lidhje me faktin nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ndonjë rol procedural në çështjen penale në ngarkim të individit A. G., trupi gjykues vëren si vijon.
- Shtetasi A. G. është hetuar në kuadër të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2018, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe më datë 05.04.2018, i është regjistruar emri si person nën hetim për veprat penale të parashikuara nga nenet 76/22/25, 278/2, 76-25, 278/2, 197/a, 109/b-1, 287/a-25, 333/a-2, 334/1 të Kodit Penal. Ky vendim është marrë nga prokurori B. T.
- Më pas, ky shtetas i është nënshtruar gjykimit për caktimin e masës së sigurisë, në të cilin prokurori që ka përfaqësuar akuzën, ka qenë z. B. T.
- Drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, znj. D. P., me urdhrin nr. {***}, datë 28.03.2019, për krijimin e grupit hetimor në lidhje me hetimin e

⁷³ Hetimet e kryera në Kolegj, në verifikimin e kësaj rrethane, janë pasqyruar në paragrafin 25/a/(i), më sipër në këtë vendim.

⁷⁴ Informacioni dhe aktet janë përcjellë në Kolegj me shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër nr. {***} prot., datë 30.04.2021 dhe protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 05.05.2021.

procedimit penal nr. {***}, të vitit 2018, ka caktuar për vijimin e hetimeve, përveç prokurorit të çështjes, z. B. T., edhe shefin e seksionit, z. Anton Martini.

Vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit janë bërë nga prokurori B. T., ndërsa shkresat për njoftimin e vendimeve për zgjatjen e hetimeve janë bërë nga prokurori Anton Martini, në cilësinë e shefit të seksionit.

Më datë 26.07.2019, është përpiluar urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nga prokurorët Anton Martini dhe B. T., edhe në lidhje me shtetasin A. G. etj. Në të njëjtën datë, prokurorët e sipërcituar kanë ndarë aktet për shtetasin A. G. etj., nga aktet e procedimit penal nr. {***}/2018, pasi kanë konkluduar se veprën penale “Përcaktimi i rezultateve në garat sportive”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 197/a/2 të Kodit Penal, shtetasit e mësipërm nuk e kanë kryer në kuadër të grupit apo organizatës kriminale, si formë e veçantë e bashkëpunimit, por në kuadër të një bashkëpunimi të thjeshtë dhe këto akte i kanë dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin e datës 25.07.2019.

Më datë 31.07.2019, aktet e ardhura për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë janë regjistruar si procedimi penal me nr. {***}/2019 nga prokurorja E. C.

Më datë 15.10.2019, lidhur me shtetasin A. G. etj., të dyshuar se ka kryer veprën penale “Përcaktimi i rezultateve në garat sportive”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 197/a/2 i Kodit Penal, është kërkuar pushimi i hetimeve nga prokurorja E. C.

Më datë 22.10.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, ka miratuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e hetimeve lidhur me shtetasin A. G. për veprën penale “Përcaktimi i rezultateve në garat sportive”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 197/a/2 i Kodit Penal.

116. Në debatin gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, Komisioneri Publik, në seancën gjyqësore të datës 27.05.2021, është shprehur se hetimi i zhvilluar në Kolegj, në lidhje me rrethanat e parashtruara në denoncimin anonim të depozituar në Kolegj, nuk e ndryshojnë kërkimin dhe shkaqet e ankimit të paraqitur prej tij, kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit.
117. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me rrethanat e parashtruara në denoncimin anonim dhe hetimin e zhvilluar në Kolegj në verifikim të tyre, në seancat gjyqësore të datave 19.04.2021 dhe 11.05.2021, si dhe në konkluzionet përfundimtare në seancën e datës 01.06.2021, parashtrori se nuk ka lidhje as me arrestimin, as me lirimin dhe as me pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit A. G. Subjekti i rivlerësimit është bërë pjesë e hetimit ndaj shtetasit A. G., vetëm pas urdhrorit të drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, por hetimet i kishte kryer prokurori B. T., i cili më datë 26.06.2019, konkludoi se shtetasit A. G. etj., veprën penale “Përcaktimi i rezultateve në garat sportive”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 197/a/2 i Kodit Penal, nuk e kanë kryer në kuadër të grupit apo organizatës kriminale, si formë e veçantë e bashkëpunimit, por në kuadër të një bashkëpunimi të thjeshtë. Meqenëse subjekti ishte bërë tashmë pjesë e grupit hetimor, pranoi arsyetimin e kolegut T. dhe aktet u dërguan për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
118. Në përfundim të hetimit të kryer për të verifikuar faktet e pretenduara në denoncim, pasi dëgjoi Komisionerin Publik dhe subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk u provuan si të tilla prej hetimeve të kryera, pasi nuk u provua se subjekti i rivlerësimit ishte pjesë e hetimit të zhvilluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe vendimi për pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit A. G. ishte marrë nga një tjetër prokuror. Për pasojë, faktet e pretenduara në denoncim nuk mund të konsiderohen relevante në lidhje me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, siç kishte pretenduar Komisioneri Publik në ankim.

Trupi gjykues nuk mund të qëndrojë pa vënë re mungesën e sinqeritetit të subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, në lidhje me faktet e pretenduara në denoncimin anonim për pushimin e procedimit penal për shtetasin A. G., pasi në seancën gjyqësore të datës 19.04.2021, ai mohoi në mënyrë kategorike përfshirjen e tij në procedimin penal lidhur me këtë shtetas, qëndrim i cili ndryshoi pas njohjes me aktet e administruara nga hetimi gjyqësor i zhvilluar në Kolegj. Në kushtet kur bëhej fjalë për fakte të pretenduara në lidhje me veprime të kryera në kuadër të një procedimi penal, të afërta në kohë, në vitin 2019, si dhe për një procedim penal të rëndësishëm, trupi gjykues e çmoi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit si mungesë bashkëpunimi në kuadër të verifikimit të fakteve të pretenduara në denoncimin e publikut.

119. Në denoncimin e paraqitur në Kolegj nga z. D.Z. (në vijim “denoncuesi”), trupi gjykues vëren se rrethanat e pretenduara nga denoncuesi se përbëjnë shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur janë:

a) subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes penale nr. {***/2013, në ngarkim të shtetasit D.Z., nuk i ka vënë asnjëherë në dispozicion dosjen e kësaj çështjeje të pandehurit dhe avokatit të tij, z. A. T., për t’u njohur me të, megjithë kërkesën e këtyre të fundit;

b) subjekti i rivlerësimit, pas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për ndarjen e çështjes penale nr. {***/2013 dhe dërgimin për kompetencë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, vonoi dërgimin e akteve për më shumë se katër muaj dhe vetëm pas ankesës së denoncuesit pranë Prokurorit të Përgjithshëm, u bë i mundur kalimi i akteve pranë gjykatës kompetente.

120. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në Kolegj, dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar Tiranë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, si pasojë e hetimit të zhvilluar, siç është pasqyruar në paragrafët 25.2 dhe 27 të këtij vendimi, trupi gjykues konstaton si vijon.

Ngapërmbytja e vendimit nr. {***}, datë 19.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. {***}, datë 16.02.2015, ka vendosur ndër të tjera ndarjen e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit D.Z., shpalljen e moskompetencës lëndore në ngarkim të tij dhe dërgimin e çështjes gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Aktet e procedimit penal nr. {***} të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit D.Z. etj., i janë përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me shkresën përcjellëse nr. {***} prot., datë 28.04.2015.

Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, çështja ka kaluar për gjykim më datë 16.03.2015. Seancat gjyqësore të datave 30.03.2015 dhe 14.04.2015, nuk janë zhvilluar dhe janë shtyrë, pasi prokurorja e çështjes ka parashtruar se nuk ishin dërguar aktet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Fashikulli i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier më datë 28.04.2015, rreth 2 muaj e gjysmë më vonë nga data 16.02.2015, datë në të cilën Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda kishte shpallur moskompetencën për gjykimin e çështjes, duke e veçuar atë dhe dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

121. Në debatin gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, Komisioneri Publik, në seancën gjyqësore të datës 27.05.2021 dhe në konkluzionet përfundimtare në seancën gjyqësore të datës 01.06.2021, parashtrou se faktet e hetuara sipas denoncimit të z. D.Z., nuk e ndryshojnë kërkimin dhe shkaqet e ankimit të paraqitura prej tij kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit.

122. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me rrethanat e parashtruara në denoncimin e z. D.Z. dhe hetimin e zhvilluar në Kolegj në verifikim të tyre, në seancat gjyqësore të datave 19.04.2021 dhe 11.05.2021, si dhe në konkluzionet përfundimtare në seancën e datës 01.06.2021, parashtrori se pas vendimit të datës 16.02.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë për ndarjen e çështjes penale në ngarkim të shtetasit D.Z., dhe dërgimin e tyre për kompetencë gjykimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, subjekti i rivlerësimit, duke qenë se kërkesa dhe vendimi për ndarjen e akteve u bënë në kuadër të kërkesave paraprake në fillim të gjyqësorisë, ka bashkëpunuar me relatorin e çështjes penale, gjyqtarin L. H., dhe administratën e tij gjyqësore për ta orientuar me aktet në ngarkim të këtij shtetasi, pasi gjyqtari nuk e njihte me detaje çështjen. Pasi aktet kanë mbërritur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, subjekti i rivlerësimit ka pasur komunikim me prokuroren për marrjen e kopjeve të akteve nga aktet e gjykatës, pasi ato ishin të plota, por ajo përsëri ka kërkuar kopje të tyre nga Prokuroria për Krimet e Rënda. Siç rezulton nga shkresa nr. {***} prot., datë 28.04.2015, subjekti i rivlerësimit ka nisur kopje të akteve të çështjes penale në ngarkim të shtetasit D.Z., për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, më datë 28.04.2015. Subjekti i rivlerësimit parashtrori gjithashtu se, në këtë rast, aktet i kishte ndarë e dërguar për kompetencë gjykimi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë për në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, e për rrjedhojë, si nga ana e prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ashtu edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nuk ekzistonte detyrim procedural për të disponuar me vendimmarrje. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga seancat gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, vetëm seanca gjyqësore e datës 14.04.2015 mund të konsiderohet pjesërisht e shtyrë për arsye të mosdërgimit të akteve, pasi pjesa tjetër i përket arsyes së njohjes me aktet nga mbrojtësi i të pandehurit. Për pasojë, mosqenia efektive vetëm e një seance gjyqësore nuk ka sjellë asnjë pasojë në një gjykim që ka zgjatur mbi 3 vite e 8 muaj, ku shumë seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së avokatit, prokurorëve dhe vetë të pandehurit.

123. Në përfundim të hetimit të kryer për të verifikuar faktet e pretenduara në denoncim, pasi dëgjoji Komisionerin Publik dhe subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të bazuara, pasi nga verifikimi i legjisllacionit procedural penal, rezulton se në rastin e disponimit me vendim gjyqësor për ndarjen e çështjes penale dhe dërgimin për gjykim gjykatës kompetente, nuk ekzistojnë dispozita procedurale që të parashikojnë detyrimin e organit të prokurorisë të dërgojë aktet pranë prokurorisë së gjykatës kompetente të ngarkuar me gjykimin e çështjes. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se faktet e pretenduara në denoncim nuk mund të konsiderohen relevante në lidhje me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

Trupi gjykues nuk mund të qëndrojë pa sjellë në vëmendje, se gjatë gjyqësorisë të çështjes në Kolegj, kërkesës së trupit gjykues për të pasur një qasje proaktive, në lidhje me qartësimin e rrethanave të pretenduara nga denoncuesi, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj me një qëndrim evaziv dhe jo të qartë, në lidhje me veprimet e kryera prej tij për dërgimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke mos dhënë kontributin e tij për të ndihmuar hetimin e trupit gjykues të Kolegjit për një gjykim efektiv dhe eficient.

124. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vëren se sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i rivlerësimit të aftësive profesionale është të identifikojë magjistratët që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Trupi gjykues i Kolegjit, në përputhje me qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 dhe në mbështetje të jurisprudencës së deritanishme të tij⁷⁵, vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016. Për rrjedhojë, për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me çështjet dhe denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi, nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

D. Vlerësimi i trupit gjykues për vlerësimin e shkaqeve të ankimit lidhur me cenimin e besimit të publikut

125. Komisioneri Publik, në trajtimin e shkaqeve të ankimit dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit, duke përdorur vlerën e një kredie të marrë me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë e mbështetje financiare që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare, si investim financiar për të përfutur interesa nga “Bono thesari” për periudhën 2007-2008 dhe interesa nga depozitat bankare për periudhën 2011-2015, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi këto veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit për qëllim përfitimi financiar, janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një prokuror.

126. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, pretendoi se shkak i ankimit i sipërcituar nuk qëndron, pasi nuk mund të valorizohet si cenim i besimit të publikut fakti që, për një periudhë kohore, me kredinë e marrë për banesë, ka blerë bono thesari në Bankën e Shqipërisë, ndërsa me fondet e përfuturara prej këtij veprimi ka paguar pjesërisht qiranë e banesës, sepse ato të ardhura që fitoheshin për këtë qëllim ishin, sa kohë subjekti nuk kishte blerë ende një banesë; ka deklaruar në ILDKPKI veprimet financiare dhe përfitimet prej tyre; më tej me këto fonde ka blerë shtëpinë duke i shtuar dhe fonde të tjera nga kursimet dhe kredia tjetër. Sipas subjektit të rivlerësimit, veprimi i kryer në menaxhimin e kredisë së dhënë nga shteti, jo vetëm është ligjor, por është edhe thellësisht njerëzor, duke e përdorur në çdo moment e fazë të lëvrimin të saj, sipas qëllimit e destinacionit të dhënë: për strehim.

127. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konkluduara nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se nga informacioni i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank⁷⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, dhe bashkëshortja e tij, në

⁷⁵Vendimi nr. 21, datë 13.09.2019, i Kolegjit: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/11/Vendimi-G-Media-i-anonimizuar-per-web.pdf>.

⁷⁶Informacion i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank, me shkresën nr. {***}prot., datë 04.01.2019.

cilësinë e bashkëkredimarrëses, kanë lidhur me këtë bankë kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2007, me objekt kredidhënie në vlerën 5.000.000 lekë, me afat shlyerjeje 25 vjet, me qëllim blerje apartamenti. Qëllimi i dhënies së kredisë është për blerje apartamenti⁷⁷. Sipas nenit 1 të kontratës së sipërcituar, kredimarrësi ka rënë dakord të paguajë shumën e kredisë dhe interesin mbi të, me kushtin paraprak të përdorimit të kredisë vetëm për qëllimin e përshkruar në kontratë – përdorimin e kredisë për blerje apartamenti.

Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, norma e interesit të aplikuar mbi kredinë është 12% vjetore. Nga kjo normë interesi, kredimarrësi do të paguajë 3% interes mbi shumën, ndërsa pjesa e mbetur e interesit do t'i paguhet bankës nga Ministria e Financave, gjatë gjithë kohëzgjatjes së afatit të kësaj kredie, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank dhe Ministrisë së Financave, datë 20.06.2005, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore”, i ndryshuar. Trupi gjykues, në analizë të veprimeve financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit pas marrjes dhe disbursimit të kredisë, vëren se subjekti i rivlerësimit, pasi ka prishur kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2006, të lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK për porositjen e një apartamenti⁷⁸, vlerën e disbursuar të kredisë e ka investuar në blerje bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë përgjatë viteve 2007 dhe 2008, duke përfituar interesat përkatës. Në periudhën 2009-2015, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, shuma e përfituar nga disbursimi i kredisë është përdorur si depozitë bankare në Raiffeisen Bank dhe si fonde investimi në Raiffeisen Invest⁷⁹. Nga verifikimi, interesatbankarë të përfituar nga subjekti i rivlerësimit si rezultat i investimit të shumës së marrë nga kredia për blerje të bonove të thesarit apo depozitë bankare dhe fond investimi, rezulton se janë gjithsej në shumën totale 217.190 lekë. Shuma e kredisë, siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, pas kryerjes së veprimeve financiare të përmendura më sipër, është përdorur për të shlyer këstin e parë të blerjes së pasurisë “apartament” në prill të vitit 2015.

⁷⁷Sipas nenit 1 të kësaj kontrate.

⁷⁸Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të përmbledhur se në muajin nëntor të vitit 2006, pasi i ishte miratuar kredia, filloi të plotësonte dokumentacionin që kërkonte Raiffeisen Bank para se të jepte kredinë në vlerën prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh. Banka kërkonte, ndër të tjera, si dokumentacion edhe një kontratë porosie për banesën për të cilën do të merrej kredia dhe në kontratën e porosisë të ishte paguar një këst. Me administratorin e shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, subjekti nënshkroi kontratën e sipërmarrjes, sipas së cilës porositi të kjo kompani një apartament, në vlerën 55.000 euro, me sip. totale 92 m², në zonën e {***} Tiranë. Meqenëse subjekti kishte nevojë të siguronte banesë për vete, pra, jo thjesht për të bërë dokumentet për bankën, ra dakord, në mirëbesim me administratorin, që sasinë prej 15.000 eurosh që ia dha në momentin e nënshkrimit të kontratës, të mund ta tërhiqte pa penalitete, nëse bashkëshortes së tij nuk do t'i pëlqente vendi ku ishte duke u ndërtuar pallati. Objektin ku gjendej apartamenti i porositur në vitin 2006 te zona e {***}, e ka parë me bashkëshorten, por edhe me ekspertët e policisë së shtetit, të cilët e kishin nën ruajtje subjektin dhe familjen e tij. Kjo zonë u konsiderua krejtësisht e papërshtatshme, me kosto të mëdha të ruajtjes, sigurisë, shoqërimit, lëvizjes dhe, si rrjedhojë, subjekti sqaroi se u detyrua të vazhdonte të jetonte në banesën që kishte me qira, e cila kishte disa elemente sigurie, me vendndodhje pranë Komisarariatit Nr. 2, Tiranë. Shtetasi A.D. ia ktheu sasinë prej 15.000 eurosh, pasi ishin kishin rënë dakord, në mirëbesim me njëri-tjetrin. Ndodhur në këto kushte, si dhe përballë faktit se shuma e marrë nga kredia nuk mundësonte blerjen e një banese në një zonë pranë qendrës së Tiranës, subjekti ka sqaruar se paratë e marra nga kredia i depozitoi në bankë dhe vendosi për të blerë disa bono thesari. Në vijim i ka depozituar në bankë në formë llogarie depozite apo fond investimi, me qëllim sigurimin e sado pak të ardhurave që t'i lehtësonin pagesën e qirasë deri në momentin që do të prenotonte apartamentin që zotëron aktualisht, si dhe pagesën e këstit të kredisë.

⁷⁹Veprimet financiare të kryera nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me shumën e disbursuar të kredisë, janë pasqyruar hollësisht në paragrafin 52.2, më sipër në këtë vendim.

128. Në analizë të kësaj situatë faktike, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, duke përdorur shumën e disbursuar të kredisë si investim në tregun e bonove të thesarit fillimisht e më pas si fond investimi, ka vepruar në kundërshtim me qëllimin e parashikuar në kontratën e kredisë bankare. Përdorimi i kredisë vetëm për qëllim të blerjes së apartamentit, ishte kushti i lidhjes së kontratës [neni 1, pika 1.2] dhe mospërdorimi i saj për këtë qëllim konsiderohet si një nga rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore [neni 13, pika 13.1, shkronja “c”], me konstatimin e të cilit banka ka të drejtë të kërkojë rikthimin e kryegjësë dhe interesave të akumuluar. Subjekti i rivlerësimit [dhe bashkëshortja e tij], megjithëse në dijeni të këtij detyrimi kontraktor, e ka përdorur shumën e përfituar nga kredia në përmbushje të qëllimit të dhënies së saj, për blerje apartamenti, vetëm pas rreth 8 vjetësh nga disbursimi i kësaj vlere. Në të kundërt, subjekti i rivlerësimit, fondet e kredisë me kushte lehtësuese, për të cilën paguante vetëm 3% të interesit bankar, pasi 9% e tyre përballohej me shpenzimet e buxhetit të shtetit, i ka përdorur për të përfituar të ardhura në formë interesash, për blerje të bonove të thesarit, duke përfituar në mënyrë të dyfishtë, së pari nga përfitimi i kredisë me interesa lehtësuese për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit dhe së dyti, duke përfituar interesa nga shteti nga investimi i kësaj kredie në kundërshtim të plotë me qëllimin e dhënies së saj.

Trupi gjykues vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimi i të cilit është detyra parësore e një prokurori. Sjellja e prokurorit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i ushtrimit të ndjekjes penale, është objekt rregullimi i normave të etikës dhe sjelljes së prokurorit, konkretisht,

Rregullat e Etikës dhe Sjelljes së Prokurorëve, në nenin 3 “Parimet themelore”, shkronja “ë” përcaktojnë: “Prokurorët në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, duhet që: [...] ë) Të jenë dhe të tregohen objektivë, të pavarur, të paanshëm, të shmangin çdo papajtueshmëri me funksionin e tyre, të ndërjegjeshëm për detyrimet etike e profesionale dhe të veprojnë në atë mënyrë që të nxisin besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre;”.

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një prokuror, i cili duhet të kujdeset që veprimet e tij të jenë në përputhje me detyrimet e marra përsipër, në kuadër të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë e mbështetje financiare që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare, interesi i së cilës përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit, duke e vendosur subjektin në situatën e kualifikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

129. Në lidhje me pretendimet e tjera të Komisionerit Publik të ngritura në ankim, në lidhje me situatat të cilat kualifikohen si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues i ka shqyrtuar dhe analizuar në paragrafët 125-128 më sipër në këtë vendim, duke i gjetur të drejta, e si të tilla e bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit, lidhur me subjektin e rivlerësimit.

130. Trupi gjykues, në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoi edhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik, si dhe të subjektit të rivlerësimit Anton Martini, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, kriterin e vlerësimit të aftësive

profesionale, si dhe vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në përfundimet e mëposhtme.

A. Për kontrollin e kriterit të pasurisë:

a) Për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe totale 97,16 m² dhe verandë 24,8 m²”, me vlerë totale 90.000 euro, subjekti i rivlerësimit:

(i) ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, lidhur me burimin e pagesës së këstit të parë të pasurisë “apartament”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

(ii) ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e këstit të parë të pasurisë “apartament”, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

b) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë, kursimeve dhe përballimin e shpenzimeve për periudhën 2003-2016, si dhe për krijimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

B. Për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me çështjet dhe denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi, nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

C. Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi:

(i) nëpërmjet përdorimit për investim në bono thesari, gjatë viteve 2007-2008, të kredisë së përfituar për strehim në kushte lehtësuese nga Raiffeisen Bank në vitin 2007, ka përfituar nga fondet e buxhetit të shtetit, në mënyrë të dyfishtë e të padrejtë;

(ii) në komunikimin me avokaten E. Ç., ka përdorur shprehje, si dhe ka kërkuar të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme për familjarët e tij, duke thyer rregullat e etikës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 3 të “Rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”;

(iii) në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ka dështuar të organizojë dhe dokumentojë shpërndarjen e çështjeve të regjistruara në këtë prokurori, bazuar në kritere objektive dhe transparente, si dhe të sigurojë përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me parashikimet e nenit 42, shkronjat “c” dhe “h” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 2, Kreu II, të udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

131. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Anton Martini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 10.06.2021.

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

RELATORE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian Hajdari

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, parashtroj mendimin tim paralel lidhur me vendimin nr. 13 (JR), datë 10.06.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen (JR) nr. 28/2010, datë 10.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Martini, për dy aspekte për të cilat nuk jam dakord me shumicën.

1. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës paraprake të subjektit të rivlerësimit

2. Në fillim të shqyrtimit të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 30.03.2021, i pyetur nga trupi gjykues nëse kishte kërkesa paraprake për gjykatën, subjekti i rivlerësimit, në prani të përfaqësuesit të tij ligjor, kërkoi shqyrtimin e kërkesës paraprake për mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik që, sipas subjektit, ishte depozituar jashtë afatit ligjor, përpara se të shqyrtonte themelin e çështjes.
3. Shumica e trupi gjykues, pasi u njoh me këtë kërkesë paraprake të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se në nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile, nuk parashikohet ankimi ndaj vendimit të KPK-së që ka pranuar ankimin e KP-së. Në këto kushte, shumica e trupit gjykues çmoi se kërkesa e subjektit të rivlerësimit në lidhje me objektin e ankimit të tij, të trajtohej në kuadër të vlerësimit tërësor të ankimit të Komisionerit Publik, duke u bazuar dhe duke pasur parasysh edhe kërkesat e nenit 450, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile.
4. Ndodhur në këtë situatë procedurale ligjore të ndjekur nga shumica e trupit gjykues, ndaj mendimin tim kundër për këto arsye:

4.1 Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë kanë trajtuar në mënyrë të qartë shqyrtimin e kërkesave paraprake, ku tipar kryesor i përbashkët i këtyre kodeve është se gjykata, pas shpalljes së përbërjes së trupit gjykues, zgjidh kërkesat paraprake të palëve, duke u shprehur në çdo rast me anë të një vendimi të ndërmjetëm, përpara shqyrtimit të çështjes në themel.

4.2 Nisur nga fakti që kërkimi i subjektit të rivlerësimit kishte të bënte me paraqitjen jashtë afatit ligjor të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, çmoj se shumica e trupit gjykues në fillim duhet të kishte trajtuar nëse ky ankimi ishte paraqitur apo jo brenda afatit ligjor dhe me vendim të ndërmjetëm të kishte vendosur për pranimin ose jo të kërkesës me objekt "Mospranimin e ankimit të paraqitur jashtë afatit ligjor", të parashikuar nga neni 63 i ligjit nr. 84/2016.

4.3 Nuk e konsideroj të drejtë faktin që kësaj kërkesë paraprake t'i jepej përgjigje përgjatë shqyrtimit të çështjes, ashtu siç ka vepruar shumica e trupit gjykues, pasi kërkimi i subjektit të rivlerësimit në kërkesën e tij paraprake, kishte natyrë të veçantë, për papërdorshmërinë e aktit/ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, si i paraqitur jashtë afatit ligjor. Trupi gjykues nuk mund të merrte në shqyrtim përmbajtjen e aktit, pa përcaktuar fillimisht nëse ky akt ishte i vlefshëm dhe a plotësonte kërkesat ligjore për të vazhduar gjykimin e mëtejshëm të çështjes. Rasti konkret, sipas kërkimit të subjektit të rivlerësimit, duhet të ishte shqyrtuar paraprakisht, ashtu siç ishte dhe natyra e vetë kërkimit në kërkesën paraprake të tij.

4.4 Vendimi për hapjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjes nga shumica e anëtarëve të trupit gjykues, pa marrë vendim të ndërmjetëm lidhur me kërkesën paraprake të subjektit të rivlerësimit për mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik, çmoj se është një shkelje e rëndë procedurale,

rrjedhojë kjo e cenimit të së drejtës së parashikuar nga Kushtetuta dhe ligji për subjektin përgjatë procesit të shqyrtimit të çështjes; raste të tilla të ngjashme çojnë në paragjykimin e çështjes.

II. Lidhur me aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

5. Ndaj mendim kundër vlerësimit tërësor të çështjes nga shumica e trupit gjykues se, *bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi nëpërmjet përdorimit për investim në bono thesari, gjatë viteve 2007-2008, të kredisë së përfituar për strehim në kushte lehtësuese nga RaiffeisenBank në vitin 2007, ka përfituar nga fondet e buxhetit të shtetit, në mënyrë të dyfishtë e të padrejtë.*
6. Lidhur me këtë konkluzion të shumicës së trupit gjykues, çmoj se në rastet e përmendura nga trupi gjykues, në asnjë moment nuk jemi përpara faktit të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit Anton Martini, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
7. *Së pari*, sa i takon konkluzionit të shumicës së trupit gjykues, se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi: (i) *nëpërmjet përdorimit për investim në bono thesari gjatë viteve 2007-2008, të kredisë së përfituar për strehim në kushte lehtësuese nga RaiffeisenBank në vitin 2007, ka përfituar nga fondet e buxhetit të shtetit, në mënyrë të dyfishtë e të padrejtë*, çmoj se:

7.1.1 Nga analizimi i dokumentacionit justifikues ligjor të administruar në dosjen gjyqësore, ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për herë të parë për kredi të butë në vitin 2007, sipas kushteve dhe rregullave ligjore të përcaktuara në ligj, pra kërkesa e tij ka qenë konform ligjit për të përfituar një kredi me kushte lehtësuese për banim.

7.1.2 Referuar dokumentacionit dhe akteve të administruara dhe nënshtruara shqyrtimit në Komision dhe në Kolegj, subjekti i rivlerësimit përpara se të aplikonte për kredi me kushte lehtësuese, nuk ka pasur pasuri në pronësi, në proces legalizimi apo ndonjë banese të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe nuk ka rezultuar që këtë kredi ta ketë transferuar te ndonjë i afërm i familjes për përfitime të tjera të ndryshme etj. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë jetuar me qira deri në blerjen e apartamentit objekt gjykimi.

7.1.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin përkatës (2007) marrjen e kësaj kredie, mospërdorimin e menjëhershëm të saj, si dhe depozitimim e shumës së kredisë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, me afat 6 muaj. I pyetur në seancë gjyqësore publike në Kolegj për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, i ndodhur në kushtet e urdhër mbrojtjes nga Policia e Shtetit, për shkak të detyrës si prokuror pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, nuk ka qenë e mundur gjetja e një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për të jetuar në qytetin e Tiranës, e për këtë arsye blerja e menjëhershme e një apartamenti në atë moment të marrjes së kredisë lehtësuese të përfituar, ishte shumë e vështirë. Subjekti ka deklaruar se ka pasur shpenzime qiraje, si dhe ka menduar që kjo shumë mos të mbahej në shtëpi, por ta kalonte në bankë në bono thesari, për një afat të shkurtër prej 6 muajsh.

7.1.4 Me konsideratëdeklarimet e subjektit në seancë gjyqësore publike dhe korrektësinë në deklarimin e situatës së tij, në vitin përkatës, të krijohet bindja që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur tendencë të fshehtë apo të ketë pasur qëllim marrjen e kësaj kredie për të përfituar në bono thesari, por ka qenë në kushtet e pamundësisë reale për gjetjen e banesës së duhur në mënyrë të menjëhershme, për të jetuar me familjen në përmbushje të kriterëve të urdhrit të mbrojtjes.

Sa më sipër, vlerësoj se Kolegji në vendimmarrjen e tij duhej të shqyrtonte çështjen në harmoni me provat dhe faktet konkrete të subjektit të rivlerësimit, të cilat, referuar rrethanave të krijuara për shkak të detyrës, rëndësisë së saj, si dhe mostendencës për fshehjen e ndonjë fakti në deklaraminipërkatës, të çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit tregon njësituatë konkrete dhe ne nuk mund të ndodhemi në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

8. *Së dyti*, sa i takon konkluzionit të shumicës së trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi, *në komunikimin me avokaten E. Ç., ka përdorur shprehje, si dhe ka kërkuar të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme për familjarët e tij, duke thyer rregullat e etikës në kundërshtim me përcaktimet e nenit 3 të “Rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”,* çmoj se:

8.1 Komunikimi privat nëpërmjet sms-ve, mes subjektit të rivlerësimit dhe avokates E.Ç., i sjellë pranë organeve të rivlerësimit për shqyrtim, duhet të ishte trajtuar në kuadër të etikës së magjistratit. Gjatë shqyrtimit të çështjes, në asnjë rast tjetër nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte probleme me komunikimin ose të ishin të përsëritura raste të tilla; për këtë arsye nuk jam dakord me kualifikimin që ka bërë shumica në këtë rast.

9. *Së treti*, referuar vendimmarrjes së shumicës së trupit gjykues për sa i përket aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit, *në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, i cili ka dështuar të organizojë dhe dokumentojë shpërndarjen e çështjeve të regjistruara në këtë prokurori, bazuar në kriteret objektive dhe transparente, si dhe të sigurojë përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me parashikimet e nenit 42, shkronjat “c” dhe “h” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 2, kreu II i udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”,* çmoj se:

9.1 Në fillim duhet bërë e qartë se kjo çështje është ngritur për shqyrtim pranë Kolegjit nga një denoncim anonim i ardhur për shqyrtim pranë institucioneve të rivlerësimit dhe në asnjë rast nuk u provua se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, për muajt dhjetor 2017 dhe janar 2018 të ketë kryer shpërndarjen e çështjeve në kundërshtim me ligjin, pasi nga dokumentacioni në dosje ka rezultuar se në muajin dhjetor 2017 ka pasur probleme sistemi CAMS për shkak të fikjes së serverave të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe dëmtimit të databazës së sistemit e mosrikuperimit të të dhënave të datës 30 nëntor 2017. Hedhja e shorteve dhe regjistrimi përkëtoçështjështëbërë manualisht në çdo prokurori.

9.2 Edhe nga leximi i kujdesshëm i udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, si dhe udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2017, “Për mënyrën e administrimit të referimeve dhe kallëzimeve penale” të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, z. G.Sh., nuk rezultoi të jetë shkelur nga subjekti i rivlerësimit ndonjë nga pikat e parashikuara në udhëzimet e sipërcituara, që do t'i adresonin përgjegjësi subjektit të rivlerësimit.

10. Në konkluzion të sa më sipër, vlerësoj se shumica e trupit gjykues, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje duhet të kishte analizuar dhe vlerësuar në harmoni provat ligjore të administruara dhe situatën faktike të subjektit të rivlerësimit të krijuar për shkak të detyrës, si faktin që subjekti ka qenë në mënyrë të vazhdueshme me urdhër mbrojtjeje fizike për vete dhe familjen, si dhe duhet të mbante parasysh faktin e kërkesave të shumta të tij gjatë ushtrimit të detyrës për dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm, për të konkluduar se nuk ndodhemi në kushtet e parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke mos cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Për rrjedhojë, e gjej të pavend zbatimin e kësaj dispozite ligjore në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Martini.

11. Lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, jam dakord me vendimin e marrë nga shumica e trupit gjykues, se subjekti i vlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për këtë kriter.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi